

INTERVISTË ME HYDAJET HYSENIN

Prishtinë | Data: 6 tetor 2015

Kohëzgjatja: 147 minuta

Të pranishëm:

- Hydajet Hyseni (I intervistuari)
- Jeta Rexha (Intervistuesja)
- Rina Krasniqi (Kamerë)

Simbolet e komenteve në transkriptë të komunikimi jo-verbal:

() - komunikim emocional

{ } - e intervistuar shpjegon me gjeste

Simbole të tjera në transkriptë:

[] - shtesë e tekstit për të lehtësuar kuptimin

Fusnotat janë shtesa editoriale të japin informacion mbi vendbanime, emra apo shprehje

Pjesa e Parë

[Pjesë e prerë nga video-intervista: intervistuesja e pyet të intervistuarin për vendin e vitin e lindjes, si dhe të flasë për familjen dhe fëmijërinë e tij.]

Hydajet Hyseni: Jam Hydajet Hyseni Kaloshi, siç jam aktualisht në Regjistrin e... Regjistrin Civil, dhe kjo ndonjëherë ka shkaktuar dilema tek njerëzit, “Ç’është ky mbiemër i pazakonshëm?!” Është pasojë n’fakt e një anomalie që ka qenë e pranishme, dhe shumë e përhapun në Regjistrin Civil të qytetarëve t’Kosovës. Shpesh herë, edhe me qëllime të caktuara që t’ngatërrohet funksionimi zyrtar, institucional... Ndoshta për këtë, po deri vonë, mbiemri im, sipas origjinës ka qenë Ibrahim, siç ishte gjyshi im. Po kur kam shkuar n’shkollë t’mesme, e kam parë se nuk mund t’jetë ai mbiemër, sepse në regjistrat civil ishte ishkuar mbiemri Iseni. Dhe Iseni është emri Hyseni, që administrata serbe - që nuk e përdorte y-në dhe kishte një mërzi sidomos për y-në e ë-në, si shkronja puro shqipe - kishte shkruar Iseni. Por, Isen nuk kishte në gjenealogjinë time. Hysen, ishte xhaxhai im. Për pasojë, ata e kishin regjistru babain tim në emër të vëllait t’tij. Emri i babait tim, vëllai i tij si mbiemër! Kështu ka qenë deri pas luftës, kur u bë një regjistrim i ri, për ne i pari i mirëfilltë, dhe ishte rasti për ta korigjuar mbiemrin tim, dhe u përcaktuam që ta marrim një mbiemër familjar. Është familjari... mbiemri familjar Kaloshi, që është emri i fisit tonë, lagjes ku kam lindur, kam jetuar.

Kam lindur në një fshat të Gjilanit, quhet Përlepnicë. Është një fshat i hershëm, mesjetar, ose ndoshta edhe më i lashtë se mesjetar. Sipas kronikave historike e legjendave, aty kishte një qytezë ose qytet, Përlep. Ndonjëherë me prapashtesën sllave, Përlepç, ku sipas kronikave e legjendave, edhe është lindja e Princ Lazarit, më saktë Princ Lazit, i cili edhe ka qenë një nga udhëheqësit e Betejës t’Kosovës, udhëheqësi kryesor i Betejës t’Kosovës, dhe që është përvetësuar krejtësisht nga historiografia serbe, dhe konsiderohet si një nga figurat historike, mitologjike, të Serbisë. Ndonëse unë kam gjetur në burime serbe, ka qenë në “Politikën e Ilustruar” dikund n’vitet e ’83 ndoshta, një shkrim i një autori serb, në të cilin ai thoshte se ky Princ Lazri, deri në vitin... deri n’shekullin e XIX-të, në të vërtetë kishte emrin Laz, dhe mbiemrin Hrebelan. Dhe kjo “ar” dhe... te emri Lazar që bëhej, dhe Hrebelan që bëhej Hrebelanoviq, është bërë tek atëherë kur n’njifarë mënyre nacionalizmi serb edhe synonte, dhe arrinte të përvetësojë edhe figura që nuk ishin serbe. Sipas këtij shkriminë “Politikën e Ilustruar” thuhej se Princi Lazër kishte prejardhje ose vllahë, ose të ndonji etnie tjetër në atë rrethinë, po që nuk ishte serbe.

Megjithate, kjo është histori e lashtë, por që lidhet me faktin që fshati Përlepnicë është një fshat vërtetë i bukur, me burime termale përreth, me mbeturina të ndonji kalaje a kështjelle, me fusha shumë të veçanta, të pllëshme dhe t’bukura, rrethuar me brigje e male plot blerim, plot zogjë. Dhe është vërtetë ndër vendet e bukura, që ja vlenë t’vizitohen.

Unë jam rritur në Përlepnice dhe jam shumë i lidhur me Përlepnicën. Aty kam kaluar fëmijërinë... dhe për mua është e paharrueshme. N'fëmijëri... edhe me figura tash të t'pavdekshme, për mua shumë t'dashura, si: Zija Shemsiu, dëshmori Zija Shemsiu, një nga ata që mbeti i vdekur nga torturat në burgun famëkeq, CZ, *Centralni Zatvor* [Burgu Qendror]e quanin, të Beogradit. E me Xhavit Ahmetin, një intelektual e veprimtar i shquar po ashtu, i cili pësoi në një aksident komunikacioni, në fund... n'vitin '97-të, në një udhëtim që atëherë bëhej për t'u takuar me përfaqësi diplomatiketë botës, e tjera.

Dhe kujtimet e mia për Përlepnicën lidhen gjithmonë edhe me këta dy emra shumë të dashur dhe t'respektuar për mua, që ishin më t'moshuar se unë, dhe ishin në një mënyrë edhe pjesë e një brezi rinor, që atëhere në përfundim t'tmerrit t'viteve '60, pas rënies të Rankoviqit, po gufonte në çdo pikëpamje.

Edhe n'formën e një fryme atdhetare, progresiste... Këta dy, ishin nxënës të Normales, edhe me shumëshokë t'tjerë, çdo rrugë që e bënim... dhe rruga ishte e gjatë - më shumë se një orë në secilin drejtim- e bënim me këngë, me mandolina, që i akordonin si çifteli e sharki, dhe këndonin këngë pa censurë. Këngë të cilat ishin t'ndaluara, dhe për t'cilat mund të dënoheshe rëndë.

Përlepnica edhe shquhet me një frymë patriotike e rezistuese ndaj pushtuesve të t'gjitha llojeve. Ka qenë vatër edhe e kryengritjeve t'ma hershme. Shumë përlepnicasë kanë marrë pjesë në luftën e Idriz Seferit, beteja t'tjera n'atë rrethinë, Kaçanik e, Karadak e... Kurse n'Luftën e Dytë Botërore, vetëm që kanë marrë pjesë në betejat e mëdha, që janë bërë në Malësinë e atëhershme t'Gollakut, e të Hashanisë... si e kanë quajtur në Kikë, Ushë, e gjetiu. Por edhe pjesa më e madhe, edhe kanë marrë pjesë në luftimet për Gjilanin. Në Përlepnice ka qenë shtabi i kryengritësve shqiptarë atëherë. Pikërisht në familjen e Zija Shemsiut, të gjyshit të Zija Shemsiut. E një pjesë, në një familje tjetër të respektuar po ashtu, që është familja e Reshat Eminut, një nga pishtarët e arsimit shqip. Për pasojë, numri i të vrarëve gjatë Luftës së Dytë Botërore n'Përlepnice ka arritë rreth 24 vetë. Kurse, nuk iu është ndalur pastaj kurrë zullumi.

Përlepnice... i cili edhe ishte qendër e grumbullimit t'kryengritësve para se të mësynin Gjilanin. Kjo Përlepnice i kushtoi me shumë të vrarë, diku rreth 24 të vrarë, kryesisht paria e fshatit, dhe një etiketim... si t'thuash, si fshat armiqësor, që fshatit i ka kushtuar shumë. Është një fshat i madh, që ka pasë shumë intelektualë, dhe ka furnizuar me intelektualë praktikisht gjithë rrethinën. Por që karrierë politike me vështirësi iu është lejuar, sepse janë konsideruar fshat armiqësor.

Unë jam rritur në një ambient t'tillë, në t'cilin midis fshatit, popullatës, dhe pushtetit, kishte një distancë t'madhe. Po në rrethin ku ishim, dhe në atë fshat në përgjithësi, ka pasë një liri për t'folur hapur kundër pushtetit. Dhe çuditërisht, nuk ka pasë shumë denoncime e spiunime, që kanë qenë atëhere praktikë shumë e përhapur. UDB-ja ka qenë një hidër që ka pasë lëshuar pipthat e saj gjithkund, dhe qe krijuar bindja se as s'mund t'flasësh diçka, e t'mos merret vesh. Po, fshati Përlepnice ka qenë në një mënyrë përjashtim.

N'fëmijërinë time, ka qenë edhe një linjë tjetër shtrënguese, përveç asaj që e bënte atë brez t'ketë një rini t'varfër në një mënyrë, një rini pa rini. Nga linja e nënës, po ashtu kishte një trashëgimi... Ky fakti i një fryme t'vazhdueshme patriotike e rezistuese ndaj pushteteve, ka qenë në një farë mënyre atmosfera n'cilën jam rritur, dhe ka qenë... t'them sinqerisht, edhe një burim gjithmonë frymëzimi e krenarie,

bashkë edhe me një rrethanë tjetër që e ka karakterizuar fshatin tim t'lindjes. Për shekuj t'tërë, në fshatin tim t'lindjes - që është fshat i madh, me më shumë se 400 shtëpi, e që janë katër pesë fise, do të thotë nuk janë një fis, një familje - nuk ka pasë vrasje mes vete. Dhe ka pasë shumë intelektualë.

Në fëmijërinë time ka qenë edhe një linjë tjetër që ka determinuar jetën time të mëvonshme: linja e nënës. Nana ime vjen prej një familje atdhetare t'anës së Dardanës tash i thonë, Kamenicës, fshatit Roganë. Është mbesa e njërit prej krerëve të asaj ane, t'pushkatuar nga pushteti i pushtuesit serb pas hyrjes së tyre në Kosovë, n'mënyrë spektakolare, n'ditën e Panairit në Gjilan, si një nga krerët e rezistencës shqiptare, Murat Kryeziut. Babai i nënës sime, do të thotë gjyshi im, Zylfi Kryeziu, ka qenë një nga luftëtarët e dalluar dhe prijatarët e luftës n'atë anë, dhe për një kohë edhe një nga kaçakët e asaj ane. Burrë shumë i respektuar n'atë anë. Bijtë e tij, Sejdi Kryeziu dhe Vehbi Kryeziu, kanë qenë pjesëtarë të njëres nga organizatat më të hershme të Lëvizjes sonë, të ripërrirë pas ripushtimit, pas Luftës t'Dytë Botërore. Sejdi Kryeziu, ka qenë tri herë i dënuar politikisht. Ka qenë shok i ngushtë i Metush Krasniqit, dhe dhëndërr i tij. Kurse vëllau i tij, Vehbiu, ka qenë pjesëtar i dalluar po ashtu i organizatës, dhe gjatë procesit t'hetimeve, ai po ashtu ka mbetur i vdekur në spitalin e Gjilanit, në rrethana shumë të dyshimta, nën mbikëqyrje dhe shtrëngim të organeve represive të kohës, të UDB-së t'atëhershme famëkeqe.

Nëna ime, ka qenë e fejuar me babain tim në prag t'Luftës së Dytë Botërore. Babai im, atëherë ishte ushtar i Mbretërisë Jugosllave, *Kraljevina Jugosllave*, edhe n'këtë cilësi arrestohet në Slloveni, pas shpërbërjes së Ushtrisë Jugosllave. Dhe pas një golgote të vërtetë nëpër kampe të ndryshme e tjera, dërgohet në kampetë përqendrimit në Gjermani. Nëna ime e ka pritur gjashtë vjet babain tim, kurse kanë qenë vetëm të fejuar, dhe asnjëherë s'e kanë parë njëri tjetrin. Ka qenë bindja se ai është i vrarë dhe se nuk do t'kthehet më.

Megjithate, edhe rrëfimet e të tjerëve përreth, edhe t'nënës sime, shpërfaqin një rast shumë t'veçantë: ajo si 16 vjeçare, megjithate vendosë që t'mos martohet n'asnjë mënyrë me askend, por të presë me çdo çmim t'fejuarin e saj. Dhe, meqë ishte luftë, dhe ajo pjesë ishte nën pushtim që ndërohej prej pushtuesve të ndryshëm, edhe pushtuesit bullgarë, që kishin një nam të zi për sjellje jo vetëm t'egra, brutale, por edhe jomorale e tjera, thonë që ishte praktikë që vajzat t'martoheshin sa më shpejtë, vetëm për t'i rahatuar disi, dhe për t'i mbrojtur n'atë mënyrë. Nëna ime, ka mbajtur përgjatë gjithë kohës t'luftës dy bomba në brez, e gatshme që po t'vie puna të hidhet në ajër bashkë me to, po nuk ka pranuar të martohet, dhe t'mos e presë t'fejuarin e saj. Fati e ka dashur, që pastaj pas Luftës së Dytë Botërore, babai im të kthehet shëndoshë e mirë, t'martohej dhe t'bëjë një familje të shëndoshë, të ngrohtë, dhe kanë jetuar në harmoni, dashuri dhe respekt t'jashtëzakonshëm reciprok.

Babai im kishte pasë sjellë prej Gjermanie një frymë liberale, progresiste, përparimtare, në një masë edhe perëndimore, që është shfaqur pastaj edhe në qëndrimin ndaj fëmijëve. Babai im ishte shumë liberal dhe mendjehapur. Bënte gjithçka për ne fëmijët, shkrinte gjithçka! Edhe pse familja e tij ishte rrënuar gjatë kohës së robërimit t'tij dhe humbjeve t'tjera që kishin ndodhë n'familje. Një vëlla i tij, që ishte gardist i ushtrisë së atëhershme, për shkak se ishte shtatlartë e tjera, kthehet i vdekur në rrethana t'paqarta nga ushtria.

Kurse familja shkatërrohet ekonomikisht, siç ka ndodhur shpesh. Dhe, prindërit e mi fillojë jetën nga fillimi. Nëna ime ishte shumë e devotshme, besimtare e jashtëzakonshme ka qenë, e dinte Kuranin përmendësh. Dhe ishte një enciklopedi e tërë e tregimeve, legjendave, këngëve historike. Unë prej saj e

kam mësuar gjithë ciklin e Këngëve t'Kreshnikëve: këngë për Gjergj Elez Alinë, Oso Kukën, Sali Shabanin, e plotë rapsodi që janë kënduar, e pjesët e eposit, unë i kam thithur bashkë me qumështin e nënës.

T'gjitha këto edhe kanë lënë rrënjë... si t'thush, në shpirtin tim, të vëllait tim të ndjerë që vdiç i ri, dhe motrave t'mija që janë rritur dhe janë shkolluar me kujdes t'jashtëzakonshëm të prindërve t'mi. Nëna ime ishte shumë fetare, shumë e devotshme, por ishte shumë e interesuar që t'i shkollonte vajzat e saj, dhe nuk i pengonte në asgjë. Unë jam rritur në ni atmosferë t'tillë: me skamje, me mungesa, por me bollëk dashurie, respekti, kujdesi, dhe për mua mbetet pjesë e kandshme e jetës. Nuk e bënë gjithmonë bollëku, pasuria, jetën dhe familjen. E bënë mbi t'gjitha ngohtësia shpirtërore. E unë i kisha ato me bollëk!

Po daja im, kalonte prej burgu n'burg. Familja e tij vuante shumë. Burgu, politika, atë kohë sillte edhe shumë mënyra tjera: bojkotime, izolime, rrënime ekonomike, pushteti rrëronte gjithçka. Dhe nëna ime e ndjerë, shkyhej në përpjekje edhe për t'na rritur ne, me mish e me thoj, edhe për t'ndihmuar familjen e vëllait t'saj, t'cilët i donte shumë, shumë, shumë. Unë shoh shumë familje, po ni dashuri si n'atë familje... ndoshta pse ka qenë e ndjekur, e persekutuar, me shumë t'vlarë, me shumë të ndjekur, edhe në Shqipëri një pjesë e tyre ka qenë e arratisur. Prandaj ndoshta edhe e kanë pasë atë afërsi të jashtëzakonshme. N'familjen time është bartur pastaj një pjesë e asaj fryme.

Po mbeten kujtime të paharrueshme për mua: ato mbrëmje kur në dritën e llampës, nëna ime ose do t'lexonte librin e saj t'shenjtë Kuranin, e na këndonte ilahi të ndryshme, ose ulej e... si i themi... nxiste duhan, ose palonte duhan, varësisht nga stina. Se kjo ishte puna që bënim ne në fshat, jetonim nga duhani. Një punë shumë e rëndë, shumë e bezdisshme. Dhe, fshehte lotë nga ne, po qante, qante, qante, pa zë, për vëllain e saj t'vdekur t'ri, për motrën e saj t'vdekur nuse t're, për dy kunatat t'saj t'vdekura nuse t'reja, për një familje që po rrënohej si pasojë e represionit politik, që ushtrohej në kohën e Rankoviqit, e pas Rankoviqit.

Rritesha unë, me vëllaun tim ma t'vjetër se unë, që ishte në një mënyrë mësuesi im i parë, dhe frymëzuesi im, sepse ishte gjatshtë vjet më i vjetër dhe ishte i brymosur me një frymë atdhetare, përparimtare, arsimdashëse. Lexonte shumë, dhe bënte ç'bënte, më blinte librat e reja që dilnin. Dhe ato vite kishin filluar dhe të vinin nga Shqipëria, Tirana... pas vitit '66. E ajo literaturë që vinte edhe legalisht, dhe filloi t'vinte dikur edhe ilegalisht, ka pasë një ndikim t'jashtëzakonshëm në edukimin atdhetar të brezave t'atëhershëm. Dhe jo vetëm n'edukimin atdhetar, brymosjen me një frymë lirisdashëse, por edhe t'ni emancipimi të përgjithshëm kulturor. Ju prandaj do t'shikni plot emra t'asaj kohe që iu viheshin fëmijëve, po mund t'mos e dini, që në t'vërtetë ata emra vinin pikërisht prej protagonistëve, personazheve, të librave që lexoheshin gjithandej.

Dhe mendoj, është rast edhe për të shprehur një mirënjohje, falenderim t'jashtëzakonshëm, për gjeneratat e tëra të mësuesëve, arsimdashësve, arsimtarëve të atyre brezave, që kanë bërë një punë prej rilindasëve, në edukimin, përgatitjen e brezave, që ma vonë do t'vazhdojnë rrugën tyre, dhe n'rrethana t'ndryshme edhe do t'luajnë rol të rëndësishëm. Vëllai im i ndjerë, Nezir është quajtur, e ka pasë emrin... ishte prej mësuesve të ri të asaj kohe. Dhe ai bënte gjithçka që unë t'lidhesha me librin, dhe të edukohesha në frymën, siç thoshte ai, "Të asaj porosie që kishim prej dajës tonë, dhe borxhit që kishim ndaj tij." Kështu disi është rinia ime... fëmijëria ime, më falni! Kështu disi është fëmijëria ime.

Pjesa e Dytë

[Pjesë e prerë nga video-intervista: intervistuesja e pyet të intervistuarin për rininë e tij.]

Unë kam lindur n'vitin '54. Kam shkuar një vit para kohe në shkollë, sepse falë edhe atmosferës që e kishim në shtëpinë tonë... nëna ime gjithë kohën rrinte me librin e saj t'shenjtë n'dorë, po që kërkonte prej nesh, që po ashtu ne t'i mbanim n'dorëlibrat tanë që kishim. Dhe, kishim mësuar shkronjat... i kisha mësuar shkronjat edhe para se ta bëja moshën shkollore, prandaj dhe kam shkuar një vit para kohe në shkollë. Dhe kam pasë fatin që të kem mësues intelektualë të fshatit, që ishin dhe janë të njohur në gjithë rrethinën, jo vetëm për modelin e mësuesit e edukatorit, siç ishte mësuesi Reshat, Reshat Emini, që është një nga figurat më të njohura të asaj ane, por edhe mësues të tjerë, që ishin elita e fshatit. Unë kam pasë rastin n'fëmiri time t'ballafaqhem edhe me frymën, edhe ankthin, e mbylljes t'shkollave... por isha fare i vogël. Flitej se shkolla n'fshat mund t'mbyllej. Megjithate, kjo nuk ndodhi, sepse ndodhën edhe ndryshimet që priteshin. Ra klika e Rankoviqit, grupi i Rankoviqit e tjerë, dhe erdhi një periudhë e njëfarë shtendosjeje, njëfarë çlirimi. Depërtoi pastaj literatura, filloi t'mësohej gradualisht edhe historia kombëtare, dhe isha brez me fat, që po rritesha këto rrethana, bashkë me moshatarët e moshataret e mija.

Kam vazhduar pastaj shkollën e mesme në Gjilan. Gjilani i binte shtatë, tetë kilometra prej fshatit, dhe duhet t'udhëtonim bashkarisht, po siç e thashë në fillim, ishte një rast i mirë që gjatë udhëtimit, ne të shoqëroheshin, të mishëroheshim njëri me tjetrin, të bënim biseda të lira, t'këndonim këngë t'ndaluara, të shkëmbenim edhe libra. Edhe legale që kishin përmbajtje atdhetare pozitive, por edhe aty këtu filluam edhe të bimë në kontakt me litetaturën e ndaluar, ilegale, që depërtonte. Dhe ajo sidomos përbihej me... si t'thushë, pasion të jashtëzakonshëm. Jo vetëm pse ishte e ndaluar, po pse ishte ëndrra e ndrydhur e brezave, edhe e prindërve tanë, edhe e brezave t'mavonshëm, po edhe brezave që po vinin.

Në gjimnazin e atëhershëm t'Gjilanit, edhe n'shkolla tjera, kishte një traditë veprimi. Gjilani ka qenë vatër e rezistencës atdhetare gjatë gjithë periudhës. Figura t'shquara të Lëvizjes sonë atdhetare janë me origjinë nga ajo anë. Edhe atë t'gjitha periudhave, e përsëris. Edhe të plejadës së rezistencës së Lëvizjes Nacional-Demokratike Shqiptare. Pastaj, organizimi me figura t'shquara që kanë qenë, si: Halim Orana, Haki Efendia, Hamdi Berisha, e të tjerë. Pastaj me periudhën e mëvonshme t'figurave atdhetare, si: Metush Krasniqi, Sejdi Kryeziu, Mark Gashi, e të tjerë. Me gjeneratën e Kadri Halimit e Ramadan Halimit, e të tjerëve, që ishin edhe bijë t'familjes t'Ramiz Cërrnicës, i cili ishte një nga figurat më respektuara gjatë luftës, dhe menjëherë pas luftës. Po që për shkak t'asaj përgjegjes historike që e kishte thënë në Kuvendin e Prizrenit, "Jo me Serbinë, po me Shqipërinë!" kishte pasur persekutime gjithë familja, edhe ai personalisht. Kishin kaluar decenie të tëra në burg, kurse i biri i tij ishte dënuar edhe me pushkatim. Dhe megjithate, kishte mbetur vatër e frymëzimit dhe e rezistencës, n'ato anë.

Unë kam pasë fatin që birin e tij ta kem një kohë arsimtar, dhe shumë prej figurave që ishin të angazhuar në Lëvizjen e atëhershme atdhetare, ose kishin lidhje familjare të tërthorta, ose t'drejtperdrejta, ose kishin me figura që ishin arsimtarë tanë, dhe kjo krijonte një atmosferë vllimi. Po kishte edhe veprimtarë që ishin pak ma t'moshuar se unë, për shembull: Rexhep Mala, Isa Kastrati, Zija Shemsiu, e tjerë, që ishin të angazhuar në forma të ndryshme, dhe u bënë pastaj protagonistët e

vjeshtës pranverore, nëntorit pranveror të '68-tës. Unë atë vit kam qenë nxënës i vitit t'parë t'shollës t'mesme, sapo kishim shkuar.

Dhe, demonstratën e '68-tës e kam përjetuar si një çlirim shpirtëror, t'veçantë. Por ishim tepër t'ri, dhe ne na bllokuan, dhe kur dolëm për dritare, si mundëm, në t'vërtetë ishte në shpërndarje e sipër. Kaluam njëfarë mënyre, vetëm nifarë përcëllimi, nifarë... si t'thushë, në mesin e t'rinjëve që po shpërndaheshin, e tjera.

Po mjaftonte kjo për t'u mishëruar me atë frymë rebelimi, ngritje... si t'thushë, që ishte një mini-kryengritje e llojit t'vet, por që te brezat e ri linte gjurmë të thella, dhe krijonte një dëshirë t'papërmbajtur që të rriteshin sa ma shpejtë, t'forcoheshin sa ma shpejt, të trimëroheshin sa ma shpejt, që edhe ata pastaj të bëheshin pjesë e një Lëvizje t'tillë. E bënte këtë edhe ma t'fuqishme literatura që lexonim dhe e shpërndanim dorë më dorë. Kangët që ndëgjoni nga Radio Tirana, dhe i shkruanin e i shpërndanim po ashtu dorë më dorë. Emisione më vonë që jepeshin nga Radio Tirana, Radio Kuksi, t'cilat kur krijuam pak bazë teknike - se atëherë ende s'kishte sa duhet kasetofonë, e tjerë - por edhe i inçizonim, edhe i shpërndanim. Kështu vepronin edhe shumë arsimtarë nëpër shkolla të ndryshme, dhe kështu është ringjallur ajo fryma patriotike që pushteti jugosllav kishte bërë përpjekje për decenie të tëra ta ndrydhte, ta shtypte, ta dërrmonte, dhe ta varroste thellë nën dhe.

Unë kam pasur fatin pastaj të jem në kontakt me Rexhep Malën, Ilmi Ramadanin, e shokë të tjerë, dhe n'atë mënyrë edhe t'fillojmë atëherë një lloj organizimi dhe veprimtarie të rregullt dhe t'organizuar politike. Me Rexhep Malën, Kadri Zekën, Ilmi Ramadanin, e kemi bërë edhe qçerthullin e parë... për ne e kam fjalën. Do të thotë, ne jemi organizuar... unë jam organizuar s'pari herë në këtë qerthull me Kadri Zekën, t'cilin e kisha shok të klasës, t'bankës, t'familjes, t'shpisë ishim, dhe me shokë t'tjerë, dhe kjo ishte mënyra si veprohej atëherë, kryesisht në treshe. Po për shkak të faktit se n'këtë rast ishim... si t'thushë, t'njohur, t'lidhur me njëri tjetrin, ndonjëherë edhe bëhej që të ishim katër, kështu me radhë. Kjo pastaj erdhi edhe u shndërrua në një... pas zgjerimit të rrathëve, edhe në celula tjera, sepse çdo celulë bënte edhe një celulë tjetër, ose secili veprimtar bënte një celulë, dy celula, dhe ato zgjeroheshin, dhe n'këtë mënyrë zgjerohej Lëvizja jonë.

Aty këtu, takonim edhe shokë që vinin prej celulave tjera, që ishin formuar më herët, ose po formoheshin, dhe u kthye në një Lëvizje që quhej me emra të ndryshëm, po ne e quanim kryesisht Lëvizje, Lëvizja Çlirimtare e Kosovës. Prandaj edhe veprimet që bëheshin, bëheshin kryesisht n'këtë emër. Prandaj edhe traktet e para që kishim shpërndarë ne në këtë cilësi, kishin titull "Lëvizja Nacional-Çlirimtare e Kosovës" dhe poshtë, pos thirrjeve tjera, kishin edhe thirrjen "Rroftë Lëvizja Nacional-Çlirimtare e Kosovës!" Me Lëvizjen Nacional-Çlirimtare të Kosovës, ne nënkuptonim jo vetëm pjesën ku ne bënim pjesë, po ishim t'vetëdijshëm se kishte edhe pjesë të tjera të organizuara n'Kosovë, me t'cilat nuk ishim në kontakt, nuk njiheshim, por e dinim se ata veprojnë, dhe besonim se në ecje e sipër, një ditë do të takoheshim, do t'njiheshim, do t'lidheshim, do t'bashkoheshim, dhe atëherë Lëvizja do të ishte edhe ma e fuqishme, edhe ma efektive. Në njëfarë mënyre, kështu edhe ndodhi.

Më vonë, gjatë studimeve... unë kam pasë regjistruar fillimisht Fakultetin Teknik, Ndërtimtarinë, por meqë kisha një dëshirë që t'registroja Gazetarinë... po atëherë s'kishte Gazetari n'Kosovë, kishte vetëm jashtë Kosove, dhe s'i kishim mundësitë materiale për t'shkuar jashtë. Dhe u hap Gazetaria... kam pasë

kaluar n'Gazetari dhe kam studiuar Gazetari Diplomaci. Dhe siç ka qenë atëherë n'modë, edhe një fakultet t'dytë, një gjuhë t'huaj, gjuhën frenge. Gjuhën Frengje e kishim mësuar edhe n'shkollë fillore, nga mësues tanë shumë të mirë, edhe për mua ishte lehtësim kjo.

Si studentë, ne vazhdonim veprimtarinë atdhetare, që përqendrohej... si t'thushë, në lexim t'literaturës t'ndryshme, diskutim rreth saj, ngritje lartësim teorik, profesional e, veprues, e tjerë... organizues. Zgjerim të rrathëve... do të thotë me veprimtarë e veprimtare tjera. Veprime të ndryshme, siç ishin shpërndarja e literaturës, ose aksione të ndryshme që bëheshin kryesisht t'karakterit propagandistik. Shkruheshin parulla, prisheshin parullat e pushtetit, shqydheshin fotografitë e figurave t'tyre t'respektuara, vendoseshin e shpërndaheshin fotografi t'figurave që ne admironim e i idealizonim. Dhe, me kalimin e kohës, shkruanim shkrime t'ndryshme, artikuj... I botonim ato në një fletushkë që atëherë filluam ta botonim, "Zëri i Kosovës." Dhe me kalimin e kohës edhe shpërndarjen e trakteve, që kishte pasë edhe një periudhë ma t'hershme... si t'thushë, raste të shpërndarjes së trakteve, po n'ato vitet '70, erdhi dhe u shëndrrua edhe në aksione që përfshinin gjithë Kosovën, për shembull t'gjitha konviktet e studentëve.

Dhomë më dhomë, shkruheshin parulla n'gjitha koridoret, dhe nuk arrihej të zbulohesh asnjë nga autorët. Mund t'them se për herë t'parë po ndodhte një fenomen i tillë, që i detyrohet edhe faktit që Lëvizja jonë, shëndrruar në Organizatë tani, po fuqizohej edhe organizativisht. Edhe kjo i detyrohet kujdesit të drejtuesve t'saj më me përvojë se ne, të cilët edhe duke nxjerrë mësim nga përvoja e organizatave të tjera, edhe kishin përgatitur instruksione dhe praktika, sipas t'cilave edhe dëshmojnë se edhe pse UDB-ja ishte vërtetë e fuqishme, e përhapur gjithandej, me shumë bashkëpunëtorë, me shumë piptha t'saj dhe me shumë mikrofona t'vendosur në gojë e njerëzve... si t'thushë, që përgjonin dhe tregonin gjithçka dëgjonin, dhe me një aparat t'fuqishëm dhe teknologjik që kishin, edhe me mbështetje financiare t'pallogaritshme nga shteti, kishin krijuar bindjen se Lëvizja atdhetare nuk mund t'i qëndrojë presionit t'UDB-ës, dhe po të bahen ma shumë se tre katër vetë, përnjherë zbulohen, bien, burgosen, dhe mbaron gjithçka.

Në t'vërtetë, në përvojën tonë po dëshmohej se kjo ndodhte, përveç tjerash, edhe për shkak të dobësive që kishim në organizim. Po kur puna bëhej me kujdesin, me fshehtësinë e duhur, me disiplinën e duhur, me... atë që ne e quanim, konspiracionin e duhur, do të thotë respektimin e rregullave t'veprimit t'fshehtë, sipas t'cilit edhe njerëzit që ishin ndonjëherë vëllezër... vëllau vëllaut nuk i tregonte ç'bënte, ç'lidhje ka me tjetrin, nuk i tregonte askujt prej familjes. Familja ime nuk ka ditur gjë për lidhjet e mia, dhe kështu ka ndodhë edhe me shokët e mi. Me shokët më të mirë ne takoheshin vetëm fshehur, natën, në vende t'caktuara, po ditën bëheshin se nuk njiheshim. Dhe në këtë mënyrë edhe ndodhi që edhe pas burgosjeve të njëpasnjëshme... megjithatë burgosjeve një hallkë, po vazhdonin të tjerat.

Kësaj i shkonte përshtat edhe kriza që po thellohej në Jugosllavinë e atëherëshme. Krizë ekonomike e gjithanshme. Një politikë represive që vazhdonte të ndiqej, me një ritëm ma t'zvogëluar pas rënies t'Rankoviçit. Po pastaj në periudha të ndryshme edhe me... si t'thushë, manifestim përsëri t'atij zellit represiv antishqiptar. Po i shkonte përshtati edhe ndikimi i fortë që kishte Republika e Shqipërisë, mjetet e saja t'informimit, Radio Tirana, shtypi i saj, depërtonin megjithatë n'kanale të ndryshme, dhe kjo sidomos në sate t'mërgimtarëve tanë.

Jugosllavia n'ato vite kishte investuar shumë që t'u çilte dyert shumë njerëzve tanë, kryesisht atyre të paarsimuar, pa ndonjë formim intelektual e tjera, që bënin një kurs profesional dhe pastaj dërgoheshin

në Gjermani, Zvicër, e gjetiu. U jepeshin pasaporta me lehtësi atyre, po nuk u jepeshin, ta zamë, intelektualëve me aq lehtësi. Dhe dihej qartë, se qëllimi ishte të zbrazej Kosova me elegancë, dhe në këtë mënyrë të realizohej plani i Çubrilloviqit për ndërrimin e strukturës etnike të Kosovës dhe territoreve shqiptare, dhe sërëbizimin e saj.

Ndoshta edhe do t'ndodhte kështu, sikur t'mos ishte fakti që atje pastaj - siç ka ndodhë në historinë tonë me kolonitë shqiptare, që kanë lujtë rol t'jashtëzakonshëm në ngritjen e Rilindjes... zhvillimin e frymës t'Rilindjes Kombëtare. Po përsëritej kjo frymë, edhe falë kujdesit të Tiranës t'atëhershme, që n'mënyra t'ndryshme i furnizonte punëtorët tanë me literaturë, me shtypin, me filma, emisione dokumentare, sllajde e tjera. Dhe gradualisht ato klubet që Jugosllavia i kishte ngritur gjithandej, si klube jugosllave, për jugosllavizimin dhe instrumentalizimin e tyre, në t'vërtetë, filluan të ktheheshin dhe të bëheshin klube atdhetare, që ishte praktikisht çlirim i mërgatës. Atje ishte më e lehtë, sepse sado që UDB-ja ishte e pranishme dhe i kërcënonte... mjaftone t'ua merrnim pasaportën dhe i prenin... do të thotë burimin e jetës, i prenin mundësinë që t'kontaktonin familjet, i rrezikonin familjet. Por megjithate, ata që jetonin në perëndim, sado kudo, kishin një hapësirë më t'madhe dhe mund të... si t'thushë, të çliroheshin shpirtërisht, duke parë edhe shokët e tyre punëtorë, që kishin edhe ata pakënaqësitë e tyre, po i manifestonin në një frymë ma t'libër, ma t'hapur. Dhe kështu, mërgata luajti një rol të jashtëzakonshëm në pamundësimin e planeve të sërëbizimit t'Kosovës dhe deshqiptarizimit të saj.

Lëvizjes sonë atdhetare, kjo i jepte një fuqi të jashtëzakonshme. Lëvizja jonë vendosi lidhje t'forta me mërgatën dhe atje u formuan organizata të ndryshme, shpesh pa ndonjë lidhje mes vete, po që kishin një kauzë t'përbashkët, dhe shpesh takoheshin në përpjekje e sipër, në punë e sipër, në rezistencë e sipër.

Unë n'ato kohë, edhe veproja ilegalisht, edhe studioja, dhe meqë kishim dhe nevoja ekonomike, fillova t'punoj si gazetar i ri, atëherë në t'vetmen t'përditshme t'Kosovës, gazetën "Rilindja." Dhe për mua ishte një rast po ashtu i jashtëzakonshëm që t'i njihja figura të shquara të inteligjencës sonë: shkrimtarë, gazetarë me nam, të gjeneratave t'ndryshme, të orientimeve t'ndryshme, t'shkollave të ndryshme, po që si tërësi ishte një shkollë po ashtu shumë e rëndësishme për mua, pos jetës universitare dhe studentore. Kështu ishte edhe me moshatarët e mi.

Po ndërkohë, kishin ndodhur burgosje të shumta, dhe kishte ndodhur ajo që përpara nuk ndodhte. Shokët si Rexhep Mala, Ilmi Ramadani, e të tjerë, ishin burgosur, ishin torturuar çnjerëzisht. Ishin burgosur në arrestime kuturu që bëheshin, pas aksioneve që ishin kryer... Autoritetet e atëhershme edhe maçina hetuese e UDB-së, nuk mërëziteshin shumë kush është autori i vërtetë, po sipas stilit që kanë praktikuar edhe gjeneralë të ndryshëm në vendet kolonialiste, që thoshin, "Nëse s'mund t'kapësh peshkun, rrëmbeje ujin..." do të thotë popullin, "dhe brenda do t'gjesh edhe peshkun."

UDB-ja atëhere, organizonte arrestime n'masë, kuturu, t'figurave t'njohura atdhetare, që sapo kishin dalë nga burgu, ose aty këtu t'afërmëve t'tyre, me shpresë se brenda tyre do t'gjejnë edhe vepruesit, dhe pastaj ata do t'flisnin dhe do t'zbuloheshin. Në t'vërtetë, për herë t'parë po ndodhte që edhe pas burgosjes t'tyre, të dënoheshin të tjerë, po veprimtaria t'vazhdonte. Ne që kishim mbetur falë qëndresës t'tyre, pastaj organizonim aksione tjera për t'dëshmuar se nuk janë ata aktorët e atyre veprimeve të inkriminuara, të dënuara, që eventualisht të liroheshin. Po pushteti atëhere represiv, nuk mërëzitej fare, vazhdonte t'i ndiqte të tjerët dhe t'i burgoste aty këtu, po ata i mbante në burg. Edhe pse konstatohej se

ata kanë qenë fare pa faj. Kështu është arrestuar edhe herën e fundit edhe Adem Demaçi me shokë, e tjerë.

Jeta Rexha: N'çfarë viti saktë?

Hydajet Hyseni: '75. Ne që kishim mbetur - dhe ndonjëherë mbeteshim pak pas arrestimeve të shumta... n'atë kohë edhe nuk ishim shumë që vepronim, në linjën tonë, kishte linja tjera që vepronin, po edhe si tërësi nuk ishin edhe aq shumë - e konsideronim si detyrë edhe më të rëndësishme, dhe më t'shenjtë që t'përkushtoheshim edhe më shumë, sepse tash përveç kauzës t'parëve tanë, amanetit t'parëve - mund ta zamë rastin tim, t'gjeneratës t'dajës tim, që po bënte burgun e tretë, n'Maqedoni tani i dënuar - unë kisha edhe... ose kishim edhe borxhin e shokëve tanë, që ishin atje. Kështu që kauza e lirisë ishte për ne gjithçka. Kishim dhe një moto atëherë, "Gjithçka për çështjen, asgjë mbi çështjen, kurgjë pos çështjes!" Duket e tepruar sot, por vërtetë kështu ishte! Dhe, kjo i kushtonte edhe familjeve, i kushtonte edhe individit, edhe karrierës tij, e tjera.

Do të thotë, unë jam tek jeta ime studentore, dhe n'ato kohë kishte një pakënaqësi n'mesin e studentëve edhe me gjendjen në t'cilën ndodhej Kosova, gjendjen politike t'saj, edhe pas një përmirësimi që kishte Kosova, pas rënies t'Rankoviçit dhe ndryshimeve kushtetuese t'vitet '74, që pritej se do ta barazonin Kosovën dhe do ta bënin Republikë. Edhe po të ndodhte kjo, për shqiptarët nuk konsiderohej si zgjidhja më e drejtë. Kosova dhe viset e tjera shqiptare ishin ndarë padrejtësisht nga trungu kombëtar, nga Shqipëria, dhe konsiderohej gjithandej se e vetmja zgjidhje e drejtë, e qëndrueshme, është bashkimi i tyre, respektimi i vullnetit t'tyre. Kjo zatën edhe ishte premtuar nga udhëheqja e Partisë Komuniste t'Jugosllavisë, para Luftës t'Dytë Botërore, dhe gjatë Luftës t'Dytë Botërore. Dhe fakti pastaj, që ma vonë kjo ishte mbytur me gjak, duke burgosur bijtë ma t'mirë të Lëvizjes t'atëhershme, edhe të krahut antifashist, po edhe t'atij tjetrit, që ishte ndonjëherë edhe i atashuar pak a shumë me fashizmin, ose nuk ishte i atashuar me fashizmin por ishte i orientimit pro perëndimor, pro anglez e, pro amerikan, ta them ashtu. Megjithatë, për pushtetit e atëhershëm jugosllav, ata që kërkonin zgjidhje t'drejtë e t'qëndrueshme, ishin një. Prandaj t'njejtën kohë, edhe ekzekutohej Gjon Serreçi e Marie Shllaku, dhe Xheladin Hana që ishte drejtor... kryeredaktor i parë i "Rilindjes." Edhe Bedri Pejani, që ishte një protagonist edhe i Lëvizjes Nacional-Revolucionare t'viteve '30, e i Komitetit Kombëtar për Mbrojtjen e Kosovës, dhe një nga protagonistët e Lidhjes së tretë t'Prizrenit. Dhe, burgosej, ta zamë... likuidohej Omer Querkezi e Nexhat Agolli, që ishin figura të orientimit antifashist, por që në sytë e pushtuesve, këta të rinj ishin e njejtë gjë.

Për pushtuesit e Kosovës, sidomos ata serbo-mëdhenjë, kurrë nuk ka qenë kryesore ideologjia. Ideologjia është përdorur ndonjëherë për hesape politike, por kriter vlerësimi ka qenë nëse dikush është vërtetë për lirinë e vendit t'vet, e t'popullit t'vet, apo jo. Nëse është i gatshëm të jetë shërbëtor e kolaboracionist, apo jo. Prandaj ajo që ka ndodhur, edhe midis dy luftërave botërore, kur krajlitë e atëhershme të Mbretërisë Serbo-Kroato-Slllovene, përkrahnin edhe kundërshtarët e Fan Nolit, që ishte peshkop, ortodoks, dhe në praktikën e politikës serbomadhe, në të cilën kisha ortodokse luante një rol t'jashtëzakonshëm t'rëndësishëm, është vështirë t'a kuptosh këtë. Rrënonin me t'gjitha mjetet një peshkop ortodoks, për t'siguruar një udhëheqje që i dukej më orientale, dhe n'pamje t'parë dukej shumë më larg prej Beogradit, por arsyeja ishte se Fan Noli, me frymën që e karakterizonte, atdhetarizimin e pastër, dhe frymën progresiste, lidhjet që kishte me botën progresiste atëherë, n'gjitha anët, përbënte

rrezik të vërtetë për planet e përbindëshme të Beogradit. Prandaj ata, edhe e pamundësonin me çdo mënyrë.

Këtë logjikë ka ndjekur edhe pas Luftës së Dytë Botërore pushtuesi i ri me petk tjetër, por që në t'vërtetë vazhdonte t'njejtën politikë ndaj shqiptarëve. Ndonjëherë është vështirë t'kuptohej kjo, sidomos prej t'huajve. Por ndoshta, fakti që në qeverinë e re të Titos ishin ndërruar pothuajse që t'gjithë kuadrot, edhe ishin ekzekutuar shumë nga intelektualët e vërtetë, edhe serbë, edhe kroatë e, sllovenë, e tjerë, t'regjimeve t'mëparshme. Por megjithatë, një nga ministrët... i vetmi që kishte ruajtur postin e tij ishte Vasa Çubrilloviq, autor i projektit për dëbimin e shqiptarëve dhe spastrimin... qysh e quanin ata etnik të Kosovës, do të thotë deshqiptarizimin e Kosovës dhe serbizimin e saj. Ky ishte një nga pjesëmarrësit në atentatin kundër Princit Ferdinand, përfaqësues i *Crna Rukës*, Dora e Zezë serbe - do të thotë një organizatë ekstreme, radikale, terroriste - i cili vjen e bëhet pastaj ministër i... për demografi i pushtetit t'ri jugosllav, që u vendos me Titon në krye, e tjera. Dhe n'këtë cilësi, si ministër i qeverisë t're, ai bën projektin e dytë për dëbimin e shqiptarëve, me t'njejtat motive.

Ata që kanë pasur iluzione se pushteti i Titos, që hiqej si ma liberal, si ma pro-perëndimor, edhe ishte më i mirë... mund edhe t'gjejnë aty këtu ndonji argument për ilustrim. Çdo kohë ka edhe pluset e minuset e vet. E imponojnë edhe rrethanat. Punojnë ndonjëherë edhe rrethanat me palën tjetër. Ishte Shqipëria në anën tjetër që bënte një trysni, dhe diçka duhej t'lëshuar pe. Por askush nuk duhet t'harrojë faktin që shpesh harrohet, që vetëm në periudhën e përfundimit t'Luftës t'Dytë Botërore, dhe menjëherë pas saj... do të thotë ato vitet '44-'45, sipas evidencës që tani botojnë historianët tanë, numri i shqiptarëve të ekzekutuar e t'masakruar sillet dikund rreth 70 mijë vetë. Imagjinoni! Në një popullatë me pothuajse gjysmë milioni, një numër aq i madh, që vështirë mund t'krahahet me cilindo nga vendet përreth. Dhe shumica prej tyre ishin civilë, gra, fëmijë, pleq... krejtësisht t'pafajshëm. Ose, intelektualë të shquar, e përsëris, të t'gjitha orientimeve, edhe të një orientimi djathtist pro perëndimor, edhe të atij tjetrit, që e quanin atëhere informbyroist, e tjera. Mjaftonte që të ishte atdhetar, dhe për pushtetin e atëhershëm ishte... ishte armik.

Kjo frymë është... ka evoluar në periudha të ndryshme, por në thelbin e saj nuk ka ndryshuar. Pas rënies t'Rankoviçit, që krijuar një situatë më e shtendosur, një rënie e represionit, një bartje e disa të drejtave dhe lirive edhe udhëheqësve shqiptarë në Kosovë, dhe kjo ka krijuar... krijoj një atmosferë të përshtatshme edhe për zhvillimin kulturo-arsimor, gjë që u mundësua edhe me ndihmën e pakursyer t'Republikës t'Shqipërisë, e cila ato kohë edhe pse kishte vështirësi të shumta vet, edhe për shkak të pozitës ndërkombëtare që kishte e tjeta, megjithatë, për Kosovën, siç thuhej edhe nga kreu më i lartë i saj, "Nuk kursehej, dhe nuk duhej t'kursehej asgjë!" Prandaj, shumica e kuadrove që mbanin edhe universitetin këtu, sidomos n'Mitrovicë e tjera, siç është thënë pastaj nga drejtuesit kosovarë t'saj, në t'vërtetë vinin nga Tirana, dhe bënë punë falas për gjithçka, dhe ofronin edhe bursa, specializime, e për aq sa do t'kishte nevojë Kosova.

Falë edhe angazhimit të inteligjencës sonë, një pjese të burokracisë shqiptare që po rritej dhe po institucionalizohej, kjo solli vërtetë një ndryshim impresiv deri n'vitet '74, që pritej t'ishte viti i kthesës edhe i barazimit të plotë të Kosovës me Republikat e tjera, gjë që ishte edhe shprehje e kërkesës t'demonstrateve t'vitit '68, që kishte kërkesën për vetëvendosje, dhe synimin që t'bëhej barazimi, si njëfarë *modus vivendi* i saj. Gjë që ishte kërkuar edhe nga udhëheqja e atëhershme... nga një pjesë e

udhëheqjes institucionale t’Kosovës, sidomos nga intelektualë të respektuar t’Kosovës e tjera, dhe ishte një kërkesë e përgjithshme. Këtu bashkoheshin t’gjithë, që është apo s’është ma e mira, barazimi me Republikat e tjera është një status... si t’thuash, *modus vivendi* është njëfarë zgjidhje, është njëfarë satisfaksioni, dhe mund t’jetë një bazë e mirë për zhvillim t’matejshëm, e tjera. Ndoshta edhe do t’ishte këtu, po t’ishte lejuar ajo. Por viti ’74 dhe kushtetuta e saj, sado që kishin... ishin një hap i rëndësishëm përpara, në t’vërtetë zhgënjeu pritjet e pjesës ma atdhetare, ma t’përkushtuar të Lëvizjës Kombëtare n’Kosovë.

Kosova mbeti në një gjendje hibride: ishte element i Federatës, por në përbërje të Serbisë. Kishte një avancim, kishte edhe kushtetutën e saj që ishte kërkuar edhe në demonstratat e ’68-tës, kishte edhe disa t’drejta, në disa aspekte edhe ekuivalente pothuajse me Republikat e tjera, por në fakt, në aspektet kryesore mbetej e diskriminuar. Mbetej e diskriminuar edhe politikisht, po sidomos ishte e diskriminuar ekonomikisht. Niveli i Kosovës jo vetëm që ishte shumë herë nën nivelin e mesatares jugosllave, të mos flasim me Republikat e zhvilluara, por pas një ngritje relative që pati, filloi pastaj ngecja e mëtejshme.

Plaçkitja e pasurive t’Kosovës po vazhdonte me intensitet të pazvogëluar. Kosova shfrytëzohej si burim lëndësh t’para, por jo edhe si vend ku do t’bëhej fabrikimi dhe shfrytëzimi nga kosovarët i pasurive t’jashtëzakonshme t’Kosovës. Besoj është e njohur, Kosova përbente rezerva veçanërisht të rëndësishme të mineraleve, prodhonte mbi 70 përqind të gjithë prodhimit të zinkut, 100 përqind të kromit, t’magneziumit, një përqindje të lartë të argjendit prodhohej në Kosovë. T’mos flasim për thëngjillin e tjera, që po t’shfrytëzoheshin nga kosovarët, Kosova shpejt do t’zinte hapin me Republikat e tjera, dhe ndoshta do t’bëhej si Ruri e Sari i Gjermanisë.

Por kjo nuk lejohej. Për pasojë, popullata e Kosovës n’njëfarë mënyre detyrohej ta braktiste vendin, dhe të shkonte për punë... Përpiqej për shkollim po me privacione t’shumta, dhe shumë e diskriminuar n’raport me moshatarët e tyre. Niveli i papunësië në Kosovë ishte shumë ma i lartë, niveli i t’ardhurave shumë më i ulët. Kosova kishte dendësinë më t’madhe t’popullsisë, ma s’paku tokë t’punueshme për familje, për kokë banori. Kështu që, përveç pakënaqësisë politike, ishte edhe një pakënaqësi sociale, që sa vinte e rritej, e thellohej.

N’vitet ’70, kjo edhe më shumë, për shkak edhe të krizës ekonomike që mbërtheu Jugosllavinë, pas borxheve që kishte marrë Jugosllavia, me dhjetra miliarda kredi nga jashtë, një pjesë e t’cilave ishin shfrytëzuar edhe nga ajo farë borgjezia e kuqe e Kosovës që thuhej, sikur nga gjithë elita e atëhershme e Jugosllavisë. Po n’Kosovë ishte proporcionalisht shumë më pak se n’viset e tjera t’Jugosllavisë, po këtu kishte krijuar, si dhe gjetiu, për një kohë iluzionen se, “Ja, jemi mirë!” Natyrisht, kur merr borxhe një familje, një kohë edhe ka një mirëqenie, një rahat. Por kur vjen puna pastaj t’paguhen borxhet, kamatat, dhe shto kësaj korrupcionin, keqpërdorimet e shumta e tjera, që atëhere kanë qenë poashtu në përmasa vërtetë... për kohën t’pazakonshme, krahasuar me vendet e tjera. Ndoshta krahashuar me sot mund t’jenë edhe ma pak! Po kjo shkaktoi një pakënaqësi t’përgjithshme, që çoi pastaj edhe në Lëvizjen e atyre viteve, ’70-ave dhe vitit ’81.

Jeta Rexha: E tash me ju pytë zoti Hydajet, ku ishit ju n’vitet e ’70-ta...?

Hydajet Hyseni: E këtu pikërisht... Unë n’atë kohë, siç thashë, isha student, punoja në “Rilindje” dhe veproja në Lëvizjen Ilegale. Por, në vitin ’78, në prill t’vitit ’78, po ndiqja një mbledhje të Odës

t’Kooperativave t’Kosovës, isha i akredituar në... atëhere Sindikatat e Kosovës edhe e ndiqja... organizata e Sindikatës atëherë ka qenë organizatë me ndikim, e fuqishme e tjera, edhe organizata të ngjajshme.

Dhe konstatova se një nga hetuesit e atëhershëm, inspektorët e Sigurimit t’Shtetit, po më vëzhgonte. Unë isha i informuar disa javë më parë, se në t’vërtetë isha nën vëzhgim të organeve t’Sigurimit. Dhe, prandaj dhe i kisha marrë masat që të ndërroja banesën dhe të jetoja në Prishtinë, edhe pse familja ishin në vendlindje, dhe kisha kujdes për gjithçka se prisja që do t’më arrestonin.

Më vonë, kisha marrë vesh se përveç dyshimeve tjera, ata kishin zënë edhe një letër që më ishte dërguar nga burgu, nga shokët atëherë, Xhafer Shatri, Rexhep Mala, dhe kishte rënë n’dorë t’tyre. Ka ndodhur që Rexhep Malës t’i zihet ndonjë letër edhe aty për aty, n’dorë, dhe ai ta gëlltiste atë. Por ka ndodhur që edhe ndonjë letër e dërguar në format që kishim atëherë, ndonjëherë nëpërmjet të burgosurve që dilnin nga burgu dhe i konsideronin t’besueshëm, ose t’i zihet dikujt letra, ose ndoshta edhe aty këtu të binte në duar të pasigurta. Por që ata pastaj të vijnë deri tek konstatimi se edhe ndonjë shkrim, siç më kanë thënë gjatë hetimeve, ndonji punum i përgatitur për botim në vitin ’74, do të thotë tri, katër, vite më herët, në gazetën “Zëri i Kosovës” që ishte zënë tek shokët e atëhershëm t’burgosur, Xhafer Shatri, Kadri Osmani, Binak Ulaj, Jashar Aliaj, e tjerë, e që nuk ishte zbuluar që ishte dorëshkrim i imi, në t’vërtetë të konstatohet nga grafologu se është tekst i imi.

Prandaj, n’atë mbledhjen thashë që isha, konstatova se po ndiqesha nga... po vëzhgohesha hap më hap... Bahesha sikur s’po e shikoj, dhe për ta konstatuar se si është puna, nëse ka ndryshuar apo është përcjelle rutinore, siç i bënin ata kohëzgjatje, dola në pauzë nga mbledhja dhe shkova në tregun e qytetit, që s’ishte larg atje. Duke menduar që aty blej diçka, bëhem sikur po blej, dhe shikoj nëse po m’ndjek ky tipi, apo jo. Por ata nuk pritën, dhe ndodhi në hyrje të tregut. M’rrethuan një numër i madh i hetuesve, dhe n’mënyrë spektakulare më paralizuan, m’kapën për krah, por duke m’thanë, “Mos lëviz, se e ke t’pamundëshme t’bësh çkado qoftë! Je n’duar t’sigurimit edhe çdo lëvizje është e kotë! Vetëm shkon poshtë!” Natyrisht s’kishte as gjasa të lëvizja. Bëhesha sikur s’di ç’është kjo. Më nxjerrin prej asaj, më fusin n’makinë dhe më dërgojnë... mendoja se po m’dërgojnë në burgun e qytetit. Ata kaluan Prishtinën, kaluan Lipjanin. Mendoja që po m’dërgojnë në burgun e Lipjanit... edhe vazhduan tutje dhe më dërguan në nifare ndërtese që kishin pasur ata, se kisha ditur përpara, në Blinajë, Lipovicë i kanë thënë përpara. Do të thotë që është njëfarë rezervati që është mbajtur si park nacional, ku sigurimi shtetëror kishte pasur një ndërtesë të veten, speciale për këso rastesh.

Ne kishim ditur se këta kishin përdorur edhe metoda t’tilla për rrëmbimin dhe trajtimin e njerëzve që i kanë konsideruar t’dyshimtë, ose kundërshtarë të regjimit. Aty mora vesh se megjithate ka rrjedhur diçka. Nxorrën edhe përpara fletoren me punimin tim që kisha shkruar, një punim t’gjatë, “Kosova nën regjimin titist”. Mund t’ua tregoj më vonë. Një shkrim i gjatë për gjendjen e Kosovës në atë kohë. Gjendjen politike, ekonomike, e tjera, aq sa mund ta shkruante një i ri n’moshën n’cilën isha unë, ishte pak më shumë se 20 vjeç. Dhe, kërkohej me ngulm që t’pranohej se është e imja. M’nxorrën përpara konstatimin e grafologut, eksperimentit, se shkrimi është i njejtë. Dhe për ta krahasuar, kishin marrë formularin me t’cilin kisha mbushur... për t’marrë letërnjoftimin. Duhej një formular t’mbushej, dhe shkronjat pastaj secilën... Gjë që vërtetë dukeshin edhe me sy të lehtë që është i njejtë. Ishte një dëshmi se s’kishim qenë sa duhet t’kujdesshëm atëherë, për të ndryshuar eventualisht edhe shkrimin. Ne kishim ndonjë makinë shkrimi atëherë, edhe e përdornim, por n’atë kohë edhe makina e shkrimit ishte punë e

madhe. Dhe ka pasë periusha kur për t'marrë një makinë shkrimi... megjithatë është mbajtur evidencë kush ka makinë shkrimi. Për kushtet e sotme është e vështirë t'pranohet... t'kuptohet kjo.

M'mbajnë gjithë ditën, gjithë natën, dhe kah mëngjesi, meqenëse s'ma dinin banesën, kërkonin ta dinin ku e kam banesën. Dëshironin t'shkonin t'kontrollonin si duket. Unë e kisha ndërruar banesën, dhe kisha shkuar me kujdes gjithmonë, do të thotë jo drejtëpërdrejtë prej punës në banesë, dhe si duket nuk e dinin. Prandaj dhe kah mëngjesi, më thanë, "Mirë, mund t'shkosh, po ti nuk na shpëton. Nuk ikë më! Ose duhet t'vish vetë, ose ne t'kemi në dorë! Dhe, veç mund ta rëndosh gjendjen tënde." Kërcënimet ishin se do t'dënohesha rëndë, do t'shkatërrojnë gjithçka, do t'shkatërrosh familjen. Unë isha i martuar, kisha fëmijë. Isha i vetmi djalë i familjes, në një mënyrë mbajtës i familjes. Dhe ata i përdornin t'gjitha këto për të bërë trysni.

Megjithate, më liruan dhe shkova në shtëpi. Bëra sikur po flija, po më shoqëronte gjithmonë një i policisë dhe kur po i them, "Po tash unë shkoj vet", nuk më ndahej, nuk më shqitej nga ajo që, "Jo po t'shoqëroj se është kohë e keqe, para mëngjesit. S'duam të ndodhë diçka." Po në t'vërtetë kur erdhi afër për ta provuar, unë dija rrugën që shkonte drejt te shpia, po i rashë më shkurt, e që ishte një rrugicë e ngushtë, me errësirë, pa drita. Dhe ai u zbraps pak, se si duket s'ishte i sigurtë çka po ndodhte, pse po hy, edhe kur po i thosha, "Po mund t'kthehesh këtu, se tash këtu është afër shtëpia dhe s'ka rrugë tjetër, kjo është." Megjithate tha, "Po m'vjen keq, po unë e kam detyrë ta mësoj shpinë ku e ke, ku je." Edhe më tregoi hapur se në t'vërtetë, ai s'ishte ardhë për t'më shoqëruar mua, po donte ta dijë shtëpinë ku e kam. Edhe u ba pastaj, kur shkuam te banesa ku isha se sikur mbaroi, edhe po kthehet, se tha, "Jam pa gjumë, kam mbetur pa gjumë," e tjera. Unë u bëra sikur fika dritën në banesë e po flija. Në t'vërtetë, qëndrova zgjuar përsëri dhe shikoja për dritare. Gjatë gjithë kohës ata sillleshin rreth banesës, dhe e kuptova se isha praktikisht n'burg, isha i burgosur. Po në burg tani në banesën time, për t'pritur kur do t'më merrnin dhe t'vazhdonin.

Prandaj shfrytëzoja rastin edhe dola sikur po blej bukë n'mëngjes, kur filloi t'zbardhej, dhe takova pastaj një veturë me policë që rrinin edhe prisnin. Jo policë, civil ishin, po policë civilë. Dhe kur kalova unë, lëvizën, u zgjuan, u mobilizuan, u ndez makina. Bëja sikur s'po e shoh, s'po dëgjoj, hyra n'rrugën tjetër, u ndez një makinë tjetër, po vinte. Dhe e kuptova se u vunë n'lëvizje. Po meqë unë e njihja atë pjesë mirë, e kisha kaluar n'kambë gjithandej, dhe kisha një përparësi n'raport me ta. Rrugë pas rrugice, u hodha në një oborr, n'oborrin tjetër, dhe dija një shtëpi t'braktisur ku hyra brenda dhe u mbylla. Lëvizën makina me... si t'thushë, dinamikë t'pa zakonshme për kohën e tjera, por megjithate nuk më gjetën. Dhe, kam pritur pastaj gjithë ditën, edhe deri n'mbrëmje vonë, dhe me kujdes t'jashtëzakonshëm kam dalë, ku kishim lidhjet pastaj me shokë t'organizatës. Edhe prej atëherë kam kaluar në ilegalitet. Kjo ka qenë me 15 prill '78, dhe kam qëndruar në ilegalitet deri në dhjetor të vitit '81. Atëherë ka qenë e pazakonshme t'qëndrohet kaq gjatë në ilegalitet, po falë organizimit që kishim, kujdesit të shokëve e tjera, kjo ka qenë e mundshme.

Pjesa e Tretë

[I intervistuari nisë të flasë para se të xhirojë kamera: elaboron për grupet e ndryshme të përfshira në lëvizjen ilegale.]

Hydajet Hyseni: Minatorë nga anë të ndryshme... atje s'më njihnin njerëzit e tjera. Ndonjë kohë edhe nëpër qytetet e tjera t'Kosovës, dhe një kohë, pak edhe për shkak të arsyeve shëndetësore që kisha, por edhe për të shkëmbyer përvojë me shokët që i kishim atje... kur kisha kaluar unë në ilegalitet, Kadri Zeka, me t'cilin ishim n'gjithë këtë veprimtari bashkarisht, ai kaloi në Zvicër, me marrëveshje ishim... dhe kështu deri në vrasjen e tij.

Unë pastaj kam kaluar në... dikun në verën e vitit '80, në Zvicër një kohë. Kam qëndruar ilegalisht po ashtu, deri në fillim të vitit... mars të vitit '81, pas demonstrates t'parë, me 24 apo 25, aty dikund... mars, jam kthyer në Kosovë.

Kishim një qëndrim që njëri prej nesh të hynte në Kosovë, tjetri të mbetej në Zvicër. N'Zvicër atëhere ishte zgjeruar po ashtu organizata, kurse n'Kosovë po ashtu kishim arritur të zgjerojmë rradhët n'masë të ndjeshme. Kishim krijuar celula t'shumta, pothuajse n'gjitha qytetet e Kosovës, dhe kishim arritur t'bëjmë aksione në gjithë Kosovën, për shembull: shpërndarje t'trakeve me rastin e Lidhjes Shqiptare t'Prizrenit, pengesave që po i nxirreshin me rastin e vizitës t'Titos në Kosovë, një trakt që kishim shpërndarë po ashtu n'gjithë Kosovën, n'gjitha qytetet, dhe për herë t'parë po shpërndaheshin trakte n'gjithë Kosovën.

M'pyete pak përpara për çështjet e dallimeve, orientimeve, e tjera. N'atë kohë nuk kishte aq shumë dallime, sepse në njëfarë mënyre, çështjet shiheshin edhe n'gro plan. Kosova ishte në gjendje të diskriminuar në Jugosllavinë e atëhershme, prandaj konsiderohej kjo si një nga çështjet kryesore që duheshin sfiduar. Gjendja ekonomike, sociale, si pasojë edhe e kësaj, ishte e randë dhe n'keqësim e sipër, dhe kjo theksohej vazhdimisht. Kërkohej që të respektohej parimi i vetëvendosjes, po atëherë filloi edhe të formësohet kjo, edhe në një formë fakti që Kosova nuk ishte e barabartë, kurse trajtohej sikur është Jugosllavia vendi i barabarsisë. e tjera. Tito merrte çmim, jo çmim m'falni, po titullin Doktor Nderi, n'Universitetin e Prishtinës për kontributin e jashtëzakonshëm në zgjidhjen e çështjes nacionale n'Jugosllavi. Gjë që nuk ishte! Dhe siç ishte thënë atëhere nga kreu i Tiranës, "E vërteta për çështjen nacionale n'Jugosllavi, do të tmerroj Titon në varr, pas vdekjes." Çështja nacionale nuk zgjidhej më slllogane "Vëllazërim, Bashkim!" dhe me diskriminim të popujve, sidomos të shqiptarëve. E vërteta ishte, dhe doli ashtu: e vërteta për çështjen nacionale n'Jugosllavi, ishte një mashtrim i madh. Sidomos me atë që ndodhi në Bosnje, e tjera.

U dëshmuar, se Bosnja konsiderohej si model i eksperimentit jugosllav, Vëllazërim-Bashkimit... njëfarë shtartimi. Duke e shformuar identitetin e tyre shqiptar, të ktheheshin në një identitet të ri, jugosllav... Si thashë, shqiptar? Edhe shqiptar. Po identitetin e tyre... ta zamë, boshnjak, kroat, serb... po krijohej njëfarë identiteti i ri jugosllav. Jugosllav filluan t'i ngjisin edhe emrat njerëzit. Aty këtu edhe ndonji shqiptar. Po jugosllav, ishte sllav i jugut, mund t'kishte një kuptim për të tjerët, po çfarë kuptimi kishte për shqiptarët? Dhe ajo që atëhere ishte shumë n'modë, dhe ishte letër shumë e rëndësishme, patriotizmi jugosllav, për shqiptarët s'kishte asnjë kuptim. Përkundrazi, kishte një kuptim antishqiptar. Sepatriotizmi jugosllav, do të thotë ishte zhbërje e patriotizmit shqiptar. Për më tepër, s'ishte vetëm n'kuptimin etnik, po ishte edhe n'kuptimin social, ekonomik, shoqëror. Ishte eliminim i perspektivës për një popull të tërë. Prandaj edhe kjo i bashkonte njerëzit t'orientimeve t'ndryshme në këtë program minimal. Liri kombëtare, barazi kombëtare e shoqërore, dhe ruajtje e frymës, dhe e andrrës së t'parëve tanë, për t'qenë t'libër e t'bashkuar. Sepse ishim ndarë padrejtësisht, ishim ndarë me forcë, nuk ishim deklaruar kurrë për t'qenë

të ndarë. Dhe praktikisht kjo ishte edhe platforma që bashkonte shqiptarët atëherë. Prandaj edhe në demonstratat e vitit '81 dolën këto parulla kryesisht në sipërfaqe.

Ne atëherë kishim filluar t'botonim një organ, një gazetë. E nxirrim si fletushkë, e nxirrshim rrallë. E quajtëm "Liria". E kishim ndërprerë atë "Zëri i Kosovës" për shkak t'burgosjeve, që t'mos krijohej përshtypja se janë ata përgjegjës edhe për këto që po bëheshin, dhe do t'mund të kishin pasoja. Dhe, ato vite kishim filluar edhe të botonim organin "Liria" pasi kishim ndërprerë botimin e organit "Zëri i Kosovës." Dhe atje kishim shpalosur edhe disa nga kërkesat që dolën e u bënë pastaj parulla edhe të demonstratave t'vitit '81. Për shembull, kishim botuar një shkrim "Jemi shqiptarë, nuk jemi jugosllavë" që doli dhe u bë një nga parullat kryesore.

Po përgatitej regjistrimi i popullsisë, dhe kësaj po i paraprinte një fushatë e orkestruar, e përgatitur shumë mirë, për të ndikuar që pos atyre që do t'regjistroheshin si jugosllavë, n'përputhje me atë orientimin t'patriotizmit jugosllav, te shqiptarët të ndikoheshin që sidomos ata të regjistroheshin si turq, tërbeshë, dhe veçanërisht myslimanë. Kishte dalur atëherë nifare Njazi Limanovcki, që ishte një nga si intelektualët e Maqedonisë, dhe ai kishte proklamuar këtë që, "Ne jemi myslimanë dhe do t'regjistrohemi si myslimanë". Në Bosnje ishte ndikuar që shumica e boshnjakëve të regjistroheshin etnikisht si myslimanë. Kjo dukej sikur ishte diçka pa sherr, s'ka gjë t'keqe, ata janë myslimanë për nga besimi fetar, por më vonë u dëshmuua se edhe kjo ishte djallëzore. Në një anë, ata nxiteshin që të identifikoheshin me identitetin mysliman, thjeshtë fetar, por në anën tjetër, Lëvizja për Pavarësi në Bosnje akuzohej dhe rrënohej, demonizohej, si një shprehje e fundamentalizmit islamik dhe një Lëvizje anti Evropë, qëbashkë me ndikimin shqiptar mund të rrezikojë të vihet si pykë për ta rrezikuar Evropën, si në mesjetë n'kohën e Turqisë, e tjera.

Kjo lojë e dyfishtë është përdorur edhe në Kosovë, në atë kohë. Dhe për t'ardhë më vonë, ka qe përdorur sidomos n'kohën e Millosheviqit, kur u bllokua arsimit shqip, arsimit sekular shqip, po t'njejtën kohë u hapën katër pesë medrese në Kosovë. Dhe në t'njejtën kohë, vazhdonte një propagandë e errshme kundër Lëvizjes sonë, si Lëvizje fundamentaliste, antievropiane, antikristiane, e tjera. Prandaj ne edhe duhej t'i përgjigjeshim kësaj, n'mënyrën tonë. Trakti që shpërndamë atëherë, dhe kryeartikulli... artikulli që shkruam në gazetën tonë, u përhap gjithandej, dhe një nga parullat n'demonstratën e '81-shës ishte, "Jemi shqiptarë, nuk jemi jugosllavë!" Madje një variant, "Jemi shqiptarë, dhe asgjë tjetër!" N'kuptimin që kombëtarisht nuk jemi as jugosllavë, as myslimanë, as turq, as tërbeshë, as çka... gjithçka që... Mund të dëshironin t'na ripagëzonin. Kishte madje atëherë një... është harruar tani, një investim bukur t'madh për t'na regjistruar një pjesë si malësorë. Malësori, thoshin, nuk janë shqiptarë. Ata janë diçka tjetër. Është bërë përpjekje me mirditorët kështu, të luajnë me identitetin e tyre. Dhe t'na bëjnë thela-thela, copa-copa.

Ose, t'burgosurit politikë shqiptarë atëherë, dërgoheshin jashtë Serbisë dhe mbaheshin nëpër burgje t'ndryshme jashtë Serbisë. Edhe pse në Kosovë qe ndërtuar një burg, që quhej i Sigurisë t'Lartë, në Dubravë. Ka qenë bërë investim i madh atëherë, edhe bukur shumë propagandë për të. Dhe ishte një kërkesë e jona për lirinë e t'burgosurve politikë, dhe kthimin e tyre n'Kosovë. Që erdhi pastaj e u bë po ashtu një nga parullat e demonstratave t'81-shës. Ose shkrimet që kishin t'bëjnë me pabarazinë ekonomike t'Kosovës, që i kishim plasuar edhe në shtypin tonë. Por ishin botuar edhe në... artikuj të ndryshëm ishin shtruar si çështje edhe n'artikuj të ndryshëm të shtypit nga Tirana. Për shembull, revista

“Ylli” kishte botuar atëherë një kryeartikull për gjendjen e rëndë ekonomike t’Kosovës, e tjera. Dhe kishte filluar këndej një fushatë e egër kundër shtypit n’Shqipëri, se po e shtrembëron të vërtetën, e tjera.

Ç’është e vërteta, këto e përplotësonin njëra-tjetrën. Dhe krijonin atë njësinë e angazhimit të të gjitha orientimeve, grupeve, t’cilat përkundër dallimeve që kishin aty këtu, megjithate e kishte ma të rëndësishme atë që ishte e përbashkët. Kështu edhe u arrit që t’krijohet ajo frymë që shpërtheu në pranverën ’81, që bashkoi pastaj t’gjithë përrejtë e pakënaqësisë në një lum t’fuqishëm, t’cilës i kontibuo shumë edhe Lëvizja në vet rrethet studentore. Grupe të ndryshme që atje po vepronin, po vetorganizoheshin, grupe t’paorganizuar po që spontanisht vepronin, grupe gjysëm t’organizuar, pjesë të mbetura t’organizatave t’burgosura, edhe ndikime tjera t’gjithfarëshe, po që bashkarisht pastaj krijuan një frymë t’shpërthimit, që çoi në pranverën ’81. Figurativisht, gjithmonë e kam krahasuar këtë me shpërthimin e pranverës. Pranvera nuk vjen vetëm në një pllajnë, në një breg, po shpërthen natyrshëm si t’thushë. Nji lule atje, nji lule këtu, nji blerim këtu, nji blerim atje, dhe bashkarisht pastaj ndërron gjithçka.

Kështu ishte edhe shpërthimi i pranverës ’81, në t’cilën edhe organizata ku unë militoja ka pasur një rol t’rëndësishëm. Ka qenë ose organizata më e organizuar, më e zgjeruar, më me jetëgjatësi ma t’madhe, dhe me fond veprimesh më t’madh. Por megjithate, ne gjithmonë e kemi vlerësuar pranverën ’81 si një shpërthim të të gjitha prurjeve, nga t’gjitha orientimet, t’gjitha organizatat, grupacionet, e tjera. Dhe mbi t’gjitha si shpërthim të rinisë t’Kosovës, që... t’cilës iu bashkua pastaj populli i Kosovës. Ju bashkua punëtorja e Kosovës, dhe vërtetë është një fuqi e jashtëzakonshme kur bashkohet rinia me punëtorinë, me fshatarësinë. Dhe ishte një Lëvizje shumë autentike, shumë popullore. Ka pasë sa e sa përpjekje për t’i demonizuar, për t’i diskredituar. Sidomos nga eksponentë të politikave zyrtare t’atëhershme, t’cilët mund edhe t’ishin befasuar, sepse jetonin në njëfarë iluzioni t’nji parajse atëherë, që për ta deri diku edhe ishte. Është ajo që filozofi antik e ka thanë, “Skllëvërit e kënaqur janë pengesa më e madhe për lirinë.” Ata që vet janë t’kënaqur, pastaj në një mënyrë pengojnë çdo përpjekje për ndryshimin e gjendjes, sepse duket sikur po ua rrezikon atyre. Por ishte një shpërthim i natyrshëm shumicës dërrmuese t’pakënaqur.

Dhe fakti që megjithate ata s’kanë mundur të gjejnë asnjë argument të qenësishëm, serioz, për akuzat spekulative, demonizuese, ndaj asaj Lëvizje, tregon që është ndër Lëvizjet e rralla n’histori, që janë vërtetë t’natyrshme, popullore, t’çiltërta, siç është rinia. Janë rinore, dhe mendoj që është faqe vërtetë e lavdishme e historisë sonë. Siç ishte edhe nëntori i ’68-tës, siç ishin pastaj edhe ato t’vitet ’89, Lëvizja Studentore e vitit ’98, rezistenca e padhunshme politike e viteve ’90 po ashtu, dhe veçanërisht pastaj edhe përballja e armatosur, me Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës në krye. Historia e botës ka shumë faqe t’lavdishme t’historisë, por këto të Kosovës kanë ndoshta këtë veçorinë: që janë autentike, janë popullore, janë burimore. Nuk janë agjenturore, nuk janë të laboratoreve të ndryshme. Këtu qëndron forca e tyre për mendimn tim, po ndoshta edhe mangësia e tyre. Sepse ato që janë agjenturore, që janë të inkubatorëve të ndryshëm, të laboratorëve t’ndryshëm, kanë pastaj edhe stimulanse të ndryshme, që edhe mund t’i veshin me ma shumë suksese, e tjera. Por megjithate, mua më imponon respekt veçanërisht kjo qenia autentike, qenia origjinale, qenia burimore, vërtetë popullore.

Pjesa e Katërt

Jeta Rexha: Zoti Hydajet, qitash noshta kishim mujtë me folë pak taman për vitin '81, kur ju edhe jeni burgosë.

Hydajet Hyseni: Po isha njëri nga pjesëmarrësit, njëri nga aktorët e '81-shës, po vetëm njëri nga ata. Unë atëherë sapo isha kthyer nga Zvicra, dhe ishim marrë vesh që Lëvizja që kishte filluar të vazhdonte, dhe ne t'përpiqeshim që ajo t'vazhdonte. Po t'përpiqeshim me aq sa kishim mundësi e ndikim, që ajo të ishte e pjekur, e përmbajtur, dhe të ishte në funksion të gjithë procesit, që sipas nesh do të zgjaste, për zgjidhjen e çështjes t'pazgjidhur t'Kosovës. Prandaj ne synonim që t'kishim ndikimin tonë n'ato procese, pa përjashtuar të tjerët. Në pranverën e vitit '81, dolën edhe ma shumë n'sipërfaqe formacionet që atëherë vepronin n'Kosovë. Dhe ishin disa të tilla. Ne ishim njëri nga ato formacione. Fillimisht grupe quheshim, pastaj organizata, me synimin që bashkarisht t'përbënim një Lëvizje unike. Dhe ishim në proces t'këtij bashkimi. Me disa prej tyre kishim vendosë kontakte, sidomos gjatë qëndrimit në Zvicër e Gjermani.

Kishte bërë një punë kolosale atje Kadri Zeka, që ishte praktikisht bashkë me Jusuf Gërvallën, e të tjerë... Bardhoshin, e të tjerë. Ishin promotorët e bashkimit, që po dizenjohej në njëfarë mënyre, po formësohej.

Unë kisha qëndruar një kohë në Zvicër, shtatë tetë muaj, t'vitit '80-'81, dhe po ashtu edhe unë kam qenë i angazhuar në këtë proces. Synimi ynë ishte që t'bashkoheshim me t'gjitha grupet e organizatat, varësisht prej natyrës që kishin ata. Me ata që do t'kishim më shumë përkime, ngjajshmëri, edhe në vision, edhe n'orientime, edhe n'mënyrën e organizimit, të bashkoheshim në një rreth më të ngushtë. Kurse me të tjerët, të mund t'bashkoheshim edhe në një rreth ma të gjerë veprimi. Me synimin që t'bënim një bashkim gjithëpopullor, si një Lëvizje gjithëpopullore, me një program që për ne ishte zgjidhje e drejtë, e përfundimtare e çështjes t'pazgjidhur shqiptare. Por me një mundësi që rrugës edhe të kishim disa periudha strategjike, të kalonim nëpër disa stacione. Dhe, n'këtë kuadër e shihnim edhe kërkesën t'cilën e kishim plasuar me kujdes, edhe gjatë vitit '80, për nevojën e barazimit edhe n'status, edhe n'gjithçka t'Kosovës me Republikat e tjera, edhe t'popullit t'Kosovës me popujt tjerë, në hapësirën e ish-Jugosllavisë. E konsideronim këtë si të nevojshme dhe të mundshme për periudhën që kalonim. Strategjikisht na dukej se ishte më e përshtatshme. Kështu edhe doli! Por pa hequr dorë nga insistimi për zgjidhje t'drejtë e t'qëndrueshme t'çështjes shqiptare.

Në vitin... në pranverën '81, edhe ndodhi ky bashkim. Ndodhi madje edhe një mobilizim në Lëvizje, edhe e një pjese t'madhe të atdhetarëve, të rinjëve, atdhetarë t'devotshëm, të guximshëm, sakrifikusë, që nuk kishin qenë t'organizuar. Problemi ishte pastaj si të menaxhohej e gjithë kjo energji. Kjo pastaj edhe solli në një mënyrë njëfarë rënie të rregullave, të konspiracionit, të diciplinës, dhe solli edhe për pasojë burgosje t'shumta. Ç'është e vërteta, ishim t'vetëdijshme se kjo do t'ndodhë. Ishim t'vetëdijshëm se mund t'na godiste edhe personalisht. Por mendonim se duhej t'paguar qoftë edhe kjo taksë, edhe ky tagër, vetëm që ne t'kalonim rubikonin, dhe t'bashkonim Lëvizjen. Pastaj kishim besimin që ajo do t'ecte përpara. Në një mënyrë, kjo edhe ndodhi. Por, Lëvizjes i kushtoi shumë.

Unë isha në demonstratën e '81-shës, me një prill, dhe pas saj kalova prapë në ilegalitet. Falë edhe ndihmës së disa demonstruesëve, veprimtarëve, falë edhe kujdesit të familjarëve që na strehuan natën e një dhe dy prillit. Madje, n'mesin e t'cilëve mua m'ka ndodhur të jem në një familje që ishte turke me kombësi. Po që qe shumë bujare. Na ofroi gjithçka që patë, ishte shtëpiplotë. Kur e pa se po rrezikohemi, na thane, "Po hyjnë po kontrollojnë shpi n'shpi, prandaj bëni si t'bëni çare." Po nuk na

denoncoi, nuk na pengoi, e tjera. Madje kemi marrë vesh ma vonë se kishin pasë dikënd që edhe paskish punuar në Punë të Brendshme. Po qe krijuar një frymë gjithandej, vërtetë positive. Ka pasë madje raste... një shok i imi, që gjatë protestës, pas ndërhyrjes brutale të policisë... se ne e kaluam këtë pjesë, që është pjesa kryesore... kishte marrë... se kishte edhe fëmijë në demonstratë, dhe sulmi ishte brutal, pa dallim... dhe për t'shpëtuar merr një fëmi dhe hynë nëpër oborre të shtëpive që ishin atje dhe një familje iu thotë, më doli një grua, dhe serbisht po më thoshte, thotë, "Ku po e çon fëminë..." thotë, "leje këtu, do ta kqyri si nana e tij. Mos ki dert!" Thotë, "Po ku guxoja ta lë në duar e një familje që fliste serbisht. Por ajo doli dhe më ofroi."

Ka pasë edhe shembuj të tillë. Urrejtja që ma vonë u mboll sidomos te pakica serbe, ishte një efekt i politikës e propagandës speciale kundër Lëvizjes. Por nuk ishte atëherë n'masën e qytetarëve. Sepse objektivisht, nuk kishte asgjë kundër qytetarëve, t'cilësdo kombësi. Dhjetëra mijëra protestues kanë qenë ato ditë në qendër të Prishtinës edhe në qendër të qyteteve tjera. Po flas aty ku kam qenë unë. Po s'ka pasë asnjë parullë anti-serbe. S'ka pasë... anti-serbe n'kuptimin kundër qytetarëve serbë, kundër identitetit, kundër kulturës, kundër gjuhës, kundër t'drejta të tyre. Jo! Ishte kundër Serbisë. Kundër Serbisë, po! Po kështu ka qenë gjithkund, lexoni edhe shtypin e kohës! Nuk ka pasë urrejtje ndërnacionale, ka pasë urrejtje ndaj regjimit. Dhe, kjo ishte letër e rëndësishme e Lëvizjes sonë, prandaj u investua shumë për ta demonizuar këtë.

Lëvizja Studentore e filloi si një protestë sociale, që kishte edhe n'sfond kërkesa politike, po nuk dolën n'plan t'parë me 11 mars. Dhe studentët kishin arsye t'shumta për t'protestuar, edhe si studentë për shkak të pozitës së tyre sociale ekonomike, kushteve që ishin dukshëm ma të liga se sa të moshatarëve t'tyre. Por kishin edhe si qytetarë t'Kosovës, dhe rinia gjithmonë prinë n'këto procese. Po ndërhyrja e policisë me dhunë, dhe sidomos përpjekja për demonizimin, diskreditimin e tyre, duke i quajtur rrugaçë, vandalë, prishës t'rendit, e tjera, e shtoi mllefin edhe ma shumë. Sidomos ndërhyrja brutale me 26 mars, edhe me njësi speciale, sidomos kundër studenteve, studenteshave protestuese, e tjera. Krijoi një mllef pastaj n'gjithë popullatën. Dhe prandaj natyrshëm erdhi ai mllef i grumbulluar dhe shpërtheu pastaj me 1 e 2 prill, dhe u kthye praktikisht në një kryengritje gjithpopullore.

Po se çfarë ishte karakteri i tyre më së miri flasin parullat e tyre. Ishin parulla t'karakterit kombëtar, se kërkoheshin t'drejta e liri kombëtare. Po ishin parulla t'karakterit demokratik sepse edhe ato kërkesat e karakterit kombëtar e demokratik, ishin t'naturës demokratike. Edhe ishte shprehje më e mirë e aspiratave që kishin qytetarët e Kosovës. Për shembull, kërkesa, "Duam Barazi!", "Duam Punë!", "Çmimeve Stop!", "Trepça punon, Kosova... Trepça punon, Beogradi ndërtohet!", "Kosova është e jona, Kosova e kosovarëve!" Kosova është e jona edhe n'kuptimin si kombinati Trepça, sepse ishte atëhere pasuria e madhe e thëngjillit edhe e energjisë, "Kosova" quhej. Po edhe ishte Kosova si territor, "Kosova është e jona, Kosova e kosovarëve!" Pastaj t'burgosurit politikë të kthehen n'Kosovë, "Jemi jugosllavë..." m'falni, duhet ta korigjoni atë, "Jemi shqiptarë, jo jugosllavë! Jemi shqiptarë dhe asgjë tjetër!" Dhe kërkesa të ngjajshme. Po nuk kishte ndonjë kërkesë që është shprehje e urrejtjes ndaj cilitdo popull, cilitdo kolektivitet, cilësdo identitet, gjuhë, kulturë, ose diçka t'ngjajshme. Nuk ka pasë as veprime t'kësaj natyre. Prandaj ishte një Lëvizje par ekselancë demokratike, dhe ishte par ekselancë e padhunshme. Dhjetëra mijëra protestues nuk kanë bërë asnjë dam. Nuk është plagosur askush para se t'ndërhynte policia. Një dhunë pastaj ka ardhë, një revoltë, pasi ka ndërhyrë policia n'mënyrë brutale. Sidomos... edhe në rastet e mëparshme me 11mars e 26 mars, por sidomos me 1prill, kur u mbush gjithë sheshi i Prishtinës.

Po premtuhej se do t'beheshin bisedime. Se do t'ftohej një grup i demonstruesëve, për t'biseduar me ta. Dhe atëherë, pa asnji paralajmërim, edhe pse n'masë kishte pleq, gra, fëmi, shpërthyen bombat me gaz lotsjellës, krisma armësh... Ndoshta jo t'gjitha n'mish, edhe n'ajër, po ishte një tmerr i vërtetë. Unë isha njëri nga pjesëmarësit, dhe njëri nga oratorët e demonstratave të '81-shës. Falë kujdesit të tjerëve që ishin, ndonji që m'njihte, disa s'më njihte, se edhe isha i lodhur, megjithate u evakuova në një nga shpitë e afërta dhe qëndrova deri n'mëngjes, dhe prej aty pastaj, përsëri me fat nëpër midis... si t'thushë, të patrullave t'policisë që ishin gjithandej, çuditërisht, megjithate arritëm të shpëtojmë, të tërhiqemi. Dhe, pastaj kam kaluar në ilegalitet edhe gjashtë muaj, ose ma shumë, shtatë muaj, dhe jam arrestuar n'dhjetor t'vitit '81.

Unë nuk mund tani ta krijoj tablonë e vërtetë të asaj kohe. Por ishte një gjendje vërtetë e papërkrahshme. U shpall gjendje e jashtëzakonshme, u vendos orë policore, filloi një luftë totale kundër gjithçkaje që ishte shqiptare, rinia ndiqej e burgosej gjithandej, diskreditohej me format ma t'vrazhda dhe me etiketat ma të rënda, imteligjenca po ndiqej, po përjashtohej nga puna, po bllokoheshin shkollat, universitetet, institucionet, po kontestohej gjithçka që ishte arritur, po demonizohej gjithçka që ishte shqiptare, po vëzhgoheshin e po kontestoheshin edhe figurat slave, madje edhe kolaboracioniste. Ishte një luftë totale anti-shqiptare. Kishte ardhur n'shpërhej atje që shqiptari vërtetë është vetëm shqiptari ose i vrazhde, ose i burgosur.

Dhe, në këto kushte, ishte e rëndë të jesh edhe jashtë burgut, pale më të jesh në duart e policisë të atëhershme speciale. Është e dhimbshme që ne nuk kemi arritur ta përshkruajmë ferrin e burgut shovinist. Por, është vërtetë i papërkrahshëm! Unë kam kaluar nja katër pesë muaj në një gjendje izolimi, që e quanin ata, "vendmbajtje në vend t'veçantë." As nuk e dije ku je ndonjëherë, dhe as nuk e dije çfarë dite është. Sepse s'kishte asgjë! S'kishte asnji mundësi kontakti. Ishte një veçim i plotë. Dhe ishin vetëm hetuesit që ndërroheshin, dhe marifetet, ustallëqet që kishin perfeksionuar ata me decenie... Tek pas nja pesë, gjashtë muajsh, kam pasë kontaktin e parë me gjykatës hetues, e avokat sipas detyrës zyrtare, për t'cilin edhe nuk e dije a është e vërtetë që është gjykatës, a është avokat, a është?! N'fund t'fundit, dukej sikur s'kishte asnji randësi! Asnji kontakt me familjen, as me askënd tjetër.

Pozita ime ishte veçanërisht e rëndë sepse vija pas katër pesë vjet, ose... aty dikund, ilegaliteti. Dhe, ishte koncentruar... si t'thushë, një presion i jashtëzakonshëm (ofshanë). Ishte një presion i vazhdueshëm, i tmerrshëm, n'cilin burgun do ta dëshiroje, sepse n'burg do t'kishte një periudhë kur je me t'burgosur, dhe po t'mund të shkëmbenje fjalë me ta, t'merrje vesh çka po ndodhë, t'dije se jo ç'po ndodhë vetëm me ty, po ç'po ndodhë me vendin, ç'po ndodhë me familjen tënde, me Lëvizjen tënde, me shokët tu. T'gjitha këto natyrisht ishin t'pamundshme n'atë... Dhe shoqëroheshin me një luftë... si t'thushë, me një përpjekje speciale për të të shartuar bindje jo reale për zhvillimet, për gjendjen, dhe jo pa pasoja beheshin këto gjithmonë.

Pas një kohe t'mbajtjes nëpër objekte të tilla, që ma vonë i kemi verifikuar në njëfarë mënyre, se kanë qenë të Sigurimeve Shtetërore, një kohë n'Shkup, një kohë... ata thoshin n'Sarajevë, po mund t'ketë qenë në Beograd dikund, dhe më kthejnë dhe më vendosin për një kohë në Leskovc, pastaj në Prishtinë. Dhe fillon nifarë si procedure gjyqësore, hetimore, pas pesë gjashtë muajsh, por në një gjendje shumë të rënduar. Dhe pas kësaj më dërgojnë në CZ [Centralni Zatvor], ku më bajnë muaj të tërë, në pjesë të... si e quanin ata, "Burgut hetues t' CZ-së." Ishte Burgu Qendror i Beogradit, burg i tmerrshëm. Dhe, një kohë

pastaj në Klinikën Psikiatrike të Burgut t'Beogradit, në t'cilin mbaheshin edhe njerëz që konsideroheshin se janë t'papërgjegjshëm, t'paaftë për t'u gjykuar. Dhe një kohë, mua më kishin vendosur në këtë status, që ishte një tmerr i llojit t'veçantë. S'kam dëshirë shumë t'i kujtoj ato çaste. Kam dëshirë edhe njëherë po t'kem mundësinë t'i hedhë në letër, t'shkruaj. Por vërtetë, është diçka nga ato që janë parë nëpër filma të ndryshëm të Luftës t'Dytë Botërore nëpër kampet naziste, herë në filma të ndryshëm për revolucionarë të pas Revolucionit Francez, dhe gjendja n'cilën janë sjellë ata.

Ajo që ishte edhe ma e rëndë ishte bindja se n'gjendje t'tillë mbaheshin shokët t'tu, shumë prej tyre ma t'ri se ne. Shumë prej tyre, në njëfarë mënyre, t'burgosur edhe në saje të ndikimit që kishim pasur ne. Ajo që na bënte krenarë dikur, kur ata vepronin me aq guxim, me aq pasion, na bënte pastaj të ndjeheshim keq për fatin që po përjetonin. Kishte të ri që takonim nëpër burgje, që ishin fare t'ri, t'njomë. T'u dersinte n'burg mustaku si t'thushë, rriteshin n'burg. Dhe ata duhej t'i hapnin gjoksin UDB-së jugosllave, që ishte tmerr. Jo veç për Kosovën, po për t'gjithë hapësirën e ish-Jugosllavisë, madje edhe më gjerë.

Ka qenë një periudhë e rëndë edhe për familjet tona. Dënimi nuk ishte vetëm individual, po praktikisht dënohej gjithë familja. Unë për një kohë t'gjatë t'burgut tim, kam pasë bindjen se e gjithë familja ime ndodhej n'burg. Kështu m'ishte thënë, dhe kështu m'ishte krijuar bindja n'forma t'ndryshme, e shkresa, e tjera, që m'i hidhnin përpara. Ndonjëherë edhe me zëra t'fëmive që ose improvizoheshin, ose inskenoheshin atje, e tjera, dhe kishe bindjen se e gjithë familja është... mbahet në burg. Kishte pasur edhe raste kur janë burgosur familje. Kanë burgosur edhe familjarë t'mi, ma vonë kam marrë vesh.

Dhe ishte presion ndonjëherë edhe me... jo vetëm me ekzekutim personal tandin, për t'cilin edhe mund t'pajtohesh, mund edhe të e shpërfillje, por shkohej tutje. Të të kërcënonin, të të bindnin se do t'shkatërronin edhe gjithë familjen, dhe gjithçka që e ke përtej. Madje, edhe përtej kësaj! Do t'shkatërronin edhe emrin e, sakrificën e, gjithçka. T'gjitha këto, ishin ma t'randa ndonjëherë sesa dhuna fizike. Izolimi i plotë, lënia me vetveten, ndikimet e presionet e jashtme, që t'mbushin pastaj me halucinacione, nganjherë kthehen në torturë edhe ma t'randë se çfardo torture fizike, shpirtërore. Prandaj kjo tortura shpirtërore, ishte torturë vështirë e mbushshme me diçka. Mund t'mbushej vetëm me ëndrrën për lirinë, me bindjen në ndershmërinë tande, të Lëvizjes tande, në drejtësinë e Lëvizjes tande t'cilës i përket, dhe eventualisht në një përpjekje shpirtërore për ta imagjinuar t'ardhmen. Për t'besuar se ajo do t'vijë një ditë, dhe për ta ëndërruar jo vetëm popullin tënd dhe vendin tënd të lirë, por edhe njerëzit e tu të lirë. Edhe vetveten ndonjëherë! Ndonjiherë kur e shoh veten sot, them, "E shikon diçka nga ato andrrat që i shihja, dhe s'besoja që do t'i realizoja. Megjithatë diçka po realizoj!" Dhe është ni satisfaksion i jashtëzakonshëm.

Pas viteve t'para t'hetimeve, pastaj ka pasë nifare çlirimi t'vogël. Do të thotë, mund t'lexoje diçka, mund t'ishe me dikend n'burg. Unë jam mbajtur nja tre vjet, kështu diçka, plotësisht i izoluar. Tek ma vonë pastaj, kam qenë në një dhomë me ndonjë t'burgosur. Dhe ajo ishte ndryshim i madh. Atëherë edhe mundtë punonim diçka, të lexonim diçka, të shkëmbejmë edhe literaturë, t'shkëmbejmë ndonji mendim. Dhe për mua ka qenë periudhë po ashtu shumë e randësishme, dhe njëfarë mënyre rilindëse.

Kam qenë në burg me figura shumë të respektuara, si: Halil Alidemën, Ali Lajçin, Bajram Kosumin, Gani Kocin, e shumë shokë t'tjerë, ma vonë n'burgje t'hapura. Dhe filluam pastaj edhe të mbushnim boshllëkun e burgut me jetën tonë, me ëndrrat tona, me idealet tona. Edhe me krijimtarinë tonë. Ndonjiherë edhe me forma t'ndryshme t'komunikimit, t'organizimit, e tjera. Dhe e gjenim pastaj këtë të realizuar tamim siç thoshte Balzaku në një roman t'tij, për burgun si boshllëk të tmerrshëm, dhe

për faktin se mund t'mundet burgu, ky boshllëk, vetëm duke e mbushur me shpirtin tend, me ëndrrat tua, me botën tënde shpirtërore. Edhe rinia e Kosovës e atëhershme, për mua... po e heq vetveten prej saj, po flas për ata që ishin ma t'ri sesa gjenerata ime, është heroike edhe nga ky aspekt. Jo vetëm që kishte bërë kthesën historike n'pranverën shqiptare t'81-shës, si edhe ato mëparshmet, por edhe kishte arritur ta mundë burgun, me shpirtin e vet, me unitetin e vet, me solidaritetin e vet.

Mua parasysh tash më dalin... ta zamë burgun e CZ-së, kur vinin eprorë ushtarakë e policorë, figura t'shquara, edhe ministra e tjerë. I hapnin dyert, i përplasin dyert, dyer kolosale t'mëdha, ushtonte gjithçka. Edhe i bënë ato me qëllim që njeriu të konsiderohej i vogël, i pafuqishëm... të tmerrohej. Dhe, vinin pastaj zyrtarët, si prej një botë tjetër. Dhe shihje pastaj djaloshin fare t'ri, t'lodhur, asht e lëkurë. Ndonjëherë t'sëmurë, ndonjëherë me mushkëri t'sëmura, dhe që drejtonte trupin, e hidhte gjoksin përpara {e ngreh gjoksin dhe kokën përpara}, kqyrte drejt në sy. Dhe kur i thoshin, "Për çka je?" thotë, "Për veprimtari politike." "Çka ke ba, neni kaq, kaq, kaq... A pendohesh për to?" Thotë, "Jo!" "Si?!" "Jo!" thotë, "jemi n'drejtën tonë." Dhe i thoshte pa i bërë syri tërr. Njëri, tjetri, kështu me radhë, dhe e shihje pastaj sikur ajo madhështia e imponuar teatrale e tyre, në njëfarë mënyre, t'dukej sikur kalamendej, dobësohej, edhe nuk ishte ajo... thyhej ajo... si t'thushë, ai miti i madhështisë së pushtetit represiv e tjera, para shpirtit të disa djelmoshave fare të rinj. Shumë prej tyre që kanë mbetur edhe sot me pasoja të rënda shëndetësore, fizike, e tjera. Unë e kam... si t'thushë, *debolezë*¹ atë brez.

Pjesa e Pestë

Jeta Rexha: Mas burgut, çka keni ba?

Hydajet Hyseni: Erdhi një kohë kur n'burg ne ishim edhe me t'burgosur tjerë, edhe t'kombësive tjera. Ka qenë ni periudhë kur kjo ishte tmerr në vete. T'burgosurit thonë, janë ma zi se burgu. Janë e keqe ma e madhe se vet burgu. Dhe shpesh ata dërgoheshin që t'ishin të tillë. Që ta bënë t'pamundur burgun. Secili prej tyre ka rrëfime, se si lihej i vetëm n'shoqëri me dy, tri, pesë, 15 ordinerë, t'dënuar secili ma zi se tjetri, secili më i çoroditur se tjetri. Devijantë, me sëmundje t'ndryshme, dhe t'porositur që të të bënin t'pamundur jetën. Dhe shpesh, njerëzit detyroheshin të gjejnë një mënyrë, qoftë edhe t'bëjnë një delikt t'vogël, që t'shkojnë në qeli, dhe atje t'jenë në beton e tjera, po s'paku t'jenë megjithate më t'sigurtë, dhe shpirtërisht ma t'qetë. Po kjo s'mund t'zgjaste gjithmonë, përsëri duhet t'ktheheshe atje. Ishte një tmerr i llojit të vet, dhe ka zgjatur shumë ky tmerr.

Po dikur ndodhën edhe do ndryshime në botë, ndodhën edhe ndryshime në hapësirën e ish-Jugosllavisë, edhe filloi edhe njëfarë hapje, dhe na linin edhe me t'burgosur tjerë. Dhe ajo që dua t'theksoj, n'fillim kishte një urrejtje t'plotë ndaj nesh. Na konsideronin armiq, nacionalistë, irredentistë, me izmat më t'zi na identifikonin. Shpesh, kjo na kushtonte edhe fizikisht. Sulme, provokime, e tjera. Po me kalimin e kohës, filluan edhe ata ta kuptojnë se ishin t'njejtën lëkurë, filluam edhe ne t'komunikojmë me ta. Dhe duket sot e pabesueshme, erdhi ni kohë që t'burgosurit politikërespektoheshin prej shumicës dërrmuese t'burgosurve tjerë. Respektoheshin për shkak se reflektonin ndryshe, ishin unik mes vete, ishin më dinjitoz, ishin më t'pjekur, lexonin më shumë, ishin ma humanistë ndaj të tjerëve dhe

¹Nga gjuha italiane: dobësi.

i ndihmonin edhe të kombësive tjera ndonjëherë kur kishte nevojë, ishin ma korrektë ndaj tyre, dhe gradualisht filloi të ndryshohej opinioni i tyre për ne. Sa ni periudhë n'burgun e Nishit dhe n'burgjet e tjera... n'burgun e Nishit ku kam qenë unë, ne arritëm të kemi gradualisht pothuajse respektin e shumicës dërrmuese të të burgosurve tjerë.

Madje edhe të një pjese të gardianëve. Kishte gardianë që lexonin, ishin njerëz të... ndryshe nga ata që ishin bisha t'vërteta. Dhe kur i shihnin këta duke lexuar vazhdimisht, i admironin. Dhe kur shkonin tek qelitë e tyre nuk e merrte pendrekun, vetëm pse nuk dëshironte ta sheh veten... si t'thushë, polic para këtij që lexonte, sepse edhe ai lexonte, bisedonin për librat, bisedonin për personazhet, e tjera. Dhe kur dilte n'shëtitore, dhe ai duhej të ruante t'mos flet njëri me tjetrin, ai mbyllte me qëllim atë dritaren, dhe i jepte shenjë shfrytëzoheni rastin, e tjera. Ishte edhe kjo anë, krahas atij tmerrit që kishin pjesa ma e madhe e gardianëve, që ishin t'porositur, ishin t'pashpirtë, xhelatë tamam. Dhe ishte kjo pjesa e t'burgosurve, që poashtu reflektonin pozitivisht. Sa në fund, kishim edhe greva e protesta t'përbashkëta, në t'cilat ndodhte që një i dënuar politik, me burg të randë politik, ishte krah për krah, dhe ishte n'përbashkë me policinë e burgut, me autoritetet e burgut, krahas me një që kishte qenë polic dhe ishte burgosur për aksident n'komunikacion, e tjera. Dhe ishte tani n'barrikadë, bashkë me t'burgosurit, edhe me t'burgosurit politik, kundër autoriteteve. Duket si një skenë e sajuar... si t'thushë, romani ose filmi, por në t'vërtetë ishin në realitet.

Dhe ishte jo një realitet krejt i izoluar. Ka pasë shkruar atëherë "Politika e Ilustruar"... jo "Politika e Ilustruar" m'falni, po "Ekspres Politika". Ka qenë një gazetë, "Ekspres Politika". Ka pasë bërë edhe një intervistë me mua, dhe na akuzonin, shkruante, "*Irredente ne miruje*", "Irredenta nuk qetësohet, nuk rri urtë." Dhe teksti ishte se Irredenta ka organizuar edhe grevën dhe protestën e madhe në Deligrad. Deligrad quhej punësoria e burgut, që kishte rreth dy mijë t'burgosur, që ishin punëtorë, që ishte taman ni kapacitet... si t'thushë, industrial. Sepse punohej në shumë reparte industriale. Dhe organizimi i një greve që ishte bërë edhe me ndikimin tonë të tërthortë, po na atribuohet si vepër armiqësore, si vazhdimësi e veprimtarisë armiqësore, edhe n'Nishë, edhe me t'burgosur. Dhe atëherë kur më patën thirrë autoritetet në burg dhëmë pyesnin, "Ju e keni organizuar!" dhe më akuzonin edhe mua drejtpërdrejtë, përgjigja ime ka pasë qenë që, "Kjo është komplimenti ma i madh që i bëhet një t'burgosuri politik, dhe që mund t'më bëhet mua n'këtë rast. Unë vetëm po druaj mos nuk është e vërtetë krejt, dhe mos po na nderoni tepër me këto që po thon!" Ishte pak edhe ironi, por e vërteta ishte edhe ashtu. Nuk ishte krejtësisht e jona. Po ishte edhe fakti që ne kishim ndërtuar raporte t'mira edhe me t'burgosur tjerë, jo-politik, shqiptarë. Dhe nëpërmjet tyre kishim arritur edhe t'lehtësonim... si t'thushë, ndikimin edhe tek t'burgosurit tjerë. Kishte aty edhe serbë e malazezë, po kishte boshnjakë, vllahë, që edhe ma lehtë... si t'thushë, identifikoheshin e afroheshin me ne.

Kjo dikur edhe ka qenë arsyeja që krijoi bindjen se ma mirë është të kthehen n'Kosovë, se sa të mbeten. Sepse do t'frikësoheshin se do t'përhapej e vërteta për '81-shën. Sepse ç'është e vërteta... si thonë, në çdo luftë, e para që vdes është e vërteta. Edhe n'luftën politike, edhe më shumë se sa n'luftën e armatosur, e vërteta vritet! Pas ngjarjeve t'81-shës, e para që qe vrarë, qe vrarë e vërteta për atë që kishte ndodhë n'81-shën. Dhe unë tek më vonë kam gjetur, kam lexuar, që ka pasur edhe intelektualë të shquar serbë, si Sergja Popoviç, që qysh atëherë, n'81-shën, ka ngritur zërin kundër asaj që po ndodhë n'Kosovë. Dhe kanë pasë guximin dhe vizionin që t'thonë që megjithatë është e drejtë ajo që kërkojnë shqiptarët. Dhe, me politikën ndaj Kosovës, dëmtohet jo vetëm Kosova, po dëmtohen Serbia edhe të tjerët. Është dëm që nuk ka pasë më shumë fuqi ky zë. Dhe nuk është e rastit! Pushtuesit janë edhe sundues t'popujve

t'tyre. Prandaj ata i frikësohen t'vërtetës edhe ndaj t'pushtuarëve, sepse e vërteta ndaj tyre mund t'i ngrehë në këmbë edhe t'sunduarit në vendet e tyre, te popujt e tyre. Prandaj edhe kanë bërë gjithçka për ta pamundësuar të vërtetën që të depërtoj atje. Unë madje jam i bindur që edhe sot e gjithë ditën, ne nuk kemi arritur ta themi t'vërtetën tonë para... edhe para qytetarëve serbë. Kur kemi arritur ta themi, efekti ka qenë befases dhe pozitiv.

Kam dalë nga burgu n'vitin '91. Në kohë ndryshimesh t'mëdha! Ndryshimet që filluan i kemi pritur n'burg. I kemi përcjellë, i kemi diskutuar, i kemi mirëpritur, falë edhe ndonji mirëkuptimi... si t'thushë, nga ndonji i burgosur, zakonisht jo-shqiptar, se ata i kishin mundësitë, kemi pasë siguruar edhe ndonji transistor që e kemi mbajtur fshehur në dhomat e burgut ku ishim. Dhe nëpërmjet tyre dëgjonim edhe lajme, informata, që jepnin radio stacionet. Po edhe Tiranën, që atëhere përsëri e ndiqnim me kujdes të veçantë. Dhe ato lajme i shpërndanim në... i shkruanim në letra dhe i shpërndanim pastaj midis t'burgosurve nga pavijoni në pavijon. Natyrisht duke rrezikuar që edhe n'burg të dënoheshe, s'paku me qeli. Megjithëse ka pasur t'burgosur që janë dënuar me burg politik, Xhafer Shatri, Isa Kastrati, e disa të tjerë, janë dënuar pasi që kanë qenë t'dënuar, për shkak të veprimtarisë në burg. Ndonjherë edhe propagandistike, ndonji libër që kanë lexuar, kanë shpërndarë, janë dënuar pastaj me vite të tjera t'burgut. Kështu që edhe ajo nuk përjashtohej.

Po i prisnim dhe i mirëprisnim. Dhe ishim t'gatshëm t'angazhoheshim në jetën pluraliste, t'cilën e konsideronim si sukses dhe një shansë historike për ne që t'leganizonim veprimtarinë e deri atëhershme politike. Kështu edhe ndodhi. Pas daljes nga burgu, një kohë kam pasë vendosur t'shikoj. Shumica e shokëve t'mi ishin të angazhuar në alternativën e atëhershme Lidhjen Demokratike t'Kosovës, dhe n'forca tjera politike. Dhe ne ishim marrë vesh në burg që të angazhoheshim nëpër parti të ndryshme politike, por atje të funksiononimpastaj si njëfarë katalizatori që e ruan unitetin, që ruan balancin, që ruan orientimin kah synimet edhe imediate edhe afatgjata kombëtare, që ruan edhe frymën kombëtare, edhe moralin që i duhet një Lëvizje t'tillë politike. Dhe mendoj që, suma sumarum edhe ka funksionuar kështu. Kemi pritur më shumë. Edhe unë kam pritur më shumë. Ka mundur më shumë, po megjithatë t'burgosurit politikë, me ndonjë përjashtim, megjithatë janë dëshmuar si forcë kohezive, pozitive, paravajtëse, dhe e ndershme kryesisht.

Alternativa e padhunshme politike për mua atëherë dukej e përshtatshme për momentin, për konjunkturën. Edhe lëvizja e '81-shës ka qenë e padhunshme politikisht. Edhe '68-ta, edhe lëvizjet e tjera, kryesisht kanë qenë t'padhunshme. Por nuk kanë qenë robë të konceptit t'padhunshëm. Nuk kanë qenë ni mos-dhunë kristiane: nëse të bjen shuplakë në njërën anë, ktheja tjetrën. Por kanë qenë më shumë respektim i porosisë së Sami Frashërit, "Ta kërkojmë me t'mirë, se e drejta mund t'kërkohej me t'mirë. Po edhe pushkën ta kemi plot!" Ta kërkojmë me t'mirë, ta provojmë me t'mirë, t'shfrytëzojmë t'gjitha mundësitë që ofron rruga e padhunshme, po t'mos bëhemi robë t'saj. Dhe defekti i alternativës t'viteve '90 është pikërisht ky, që me strategjinë e padhunshme u teprua. Dhe thojnë, mënyra më e mirë për t'diskredituar diçka të drejtë, është ta çosh n'absurd. Ta kthesh n'absurd. Është e vërtetë që strategjia e padhunshme politike e viteve t'90-ta, u kthye në një jo Lëvizje t'padhunshme politike, siç thoshte Gandi e të tjerë... Dhe Gandi thoshte, "Po t'jetë puna të zgjedhë në mes qyqarllëkut dhe luftës, unë luftën zgjedhë!" Gandi nuk ishte sikur adventistët që s'duan të dëgjojnë për armën, për dhunë. Po ai besonte në potencialin e dhunës t'padhunshme, prandaj e shfrytëzonte maksimalisht, dhe është model i saj. Por ta kthesh në t'kundërtën e saj, do të thotë ta pacifikosh dhe ta pasivizosh një lëvizje t'padhunshme politike. Mendoj që ky ishte gabimi që ishte, dhe që ishte vërejtur

gjatë atyre viteve, dhe na kushtoi shumë. I kushtoi edhe Kosovës, dhe i kushtoi edhe vet Lëvizjes t'padhunshme politike.

Unë kam qenë për këtë t'dytën: Lëvizje e padhunshme po, po aktive, edhe pasive, kombinim i tyre. Dhe institucionaliste. Ne bëmë Kuvendin, prandaj mendonim që duhej t'thirrë Kuvendin, edhe nësa na burgosnin. Dhe n'këtë kuptim ne patëm një mospajtim me udhëheqjen e LDK-së t'atëhershme. Unë isha nënkryetar i LDK-së, dhe kam pasë konsideratën, respektin edhe për drejtuesit tjerë. S'kemi pasë kurrë kurgja personale, por tek rruga që duhej t'ndiqnim kishim në këtë periushë edhe dallime. Ne bëmë zgjedhjet, dhe kishte një hezitim për t'thirrur Kuvendin. Madje kishte një qëndrim t'mos e thirrnim Kuvendin, prandaj ne kemi ofruar, "Po e thërrasim ne, dhe po e marrim ne përgjegjësinë. Nëse del keq, ne burgosemi, ne nashta edhe vritemi, po le t'ecë procesi përpara". Dhe të tjerët le t'vazhdonin. Megjithate nuk u lejua.

Edhe Adem Demaçi pranoi të hynte në këtë lojë. T'hynte në Kuvend dhe të merrte ai përgjegjësinë, sepse atëherë e mori çmimin "Saharov" të Këshillit t'Evropës, dhe kishte mundësi të angazhonte edhe europarlamentarë në këtë lojë. Kishte edhe premtime nga ata, "Nëse ju e thirrni Kuvendin, ne do t'vijmë!" Dhe për mendimin tim ishte rast shumë i mirë që ne të sfidonim n'këtë mënyrë me mos dhunën tonë, po edhe pasive, edhe aktive, edhe institucionale, gjithpërfshirëse. Taman gandiste!

Nuk u bë kjo, po për pasojë breza t'tërë po iknin jashtë. Po dëbonin! Serbia po akomodohej mirë në Kosovë. Ajo ose dëshironte ni mos-dhunë t'paefektshme, që filloi të bëhet n'fund t'viteve '90, ose ni aventurë t'armatosur t'cilën do ta thyente lehtë. Ne duhej t'mos ia jepnim asnjërën shansë, dhe mendoj që kemi bërë mirë që nuk kemi rënë në asnjërën prej këtyre dy grackave. Ne nuk e morëm, ose nuk e mbajtëm flamurin e Lëvizjes t'padhunshme politike, si paravajtëse, avancuese, dhe doli pastaj alternativa e Rinisë Studentore. Studentët e morën këtë nismë n'vitin '97. Dhe ne prapë aty patëm një ndarje. Lëvizja Studentore ishte e drejtë! Kërkonte shkollën, kishte një të drejtë elementare. Rrezikonte pak, po duhej t'rrezikonte. Prandaj ne u ndamë: ata që e kundërshtonin, dhe ata që përkrahnin.

Për më tepër ndodhi pastaj edhe një gjë që s'duhej t'ndodhte. Alternativa e padhunshme ishte demokratike, dhe kishte letër t'fortë t'dimensionit demokratik. Po qenia demokratike duhej t'dëshmohej n'radhë t'parë në funksionimin demokratik, në konsistencën, në funksionimin demokratik. U degrada funksionimi demokratik! U kthye në njifarë formaliteti që kontrollohej, menaxhohej, dhe abuzohej nga një rreth i lidershipit. Vazhdimi i kësaj logjike e bënte edhe ma të rrezikshme atë paralizën që ishte imponuar nga pushteti. Prandaj edhe u krijuan t'gjitha rrethanat, po e përsëris, edhe sidomos funksionimi jo- demokratik n'fund, imponimi i... edhe i udhëheqjeve, e tjera, sipas kuteve. Madje në një kontekst shumë problematik, kur nga Beogradi po ofrohej edhe ni lloj marrëveshje me Kosovën, por në suaza t'Serbisë, me një kthim të disa t'drejtave që ishin rrëmbyer. E Kosovës i ishin rrëmbyer atëherë praktikisht t'gjitha t'drejtat, ishin rrënuar t'gjitha institucionet. Dhe sipas asaj logjikës, kur fëmija kërkon djathin, merrjabukën, dhe ai harron djathin. Kosova kishte rrezik atëherë t'kënaqej me bukën që t'i kthehej, dhe kurrëgjë ma tepër. Serbia atëherë jepte sheja se ishte e gatshme. Edhe Serbia zyrtare, edhe Serbia kuazi- opozitare, ishte e gatshme që t'hynte n'pazare me udhëheqjen e Kosovës. Po me një pjesë t'udhëheqjes t'Kosovës. Me kushtin që zgjidhje të gjendej brenda Serbisë, me disa t'drejta ekonomike, arsimore, kulturore, e tjera. Po pa pavarësi e Republikë, dhe me kushtin që t'hiqeshin prej tryeze qysh i quanin ata, irredentistët. Do të thotë përfaqësuesit, ose pjesëtarët e Lëvizjes atdhetare që kishte ardhë prej brezave të ndryshëm.

Kjo ishte arsyeja pse ne s'mund t'shkonim më bashkë. Ndodhi ndarja n'Lidhjen Demokratike t'Kosovës, dhe u formua Lëvizja e Bashkuar Demokratike, që synonte bashkimin e gjithë spektrit politik shqiptar. Dhe, në këtë kohë edhe të UÇK-së, sepse si pasojë e kësaj që thashë, trysnisë t'madhe t'Beogradit dhe vazhdimësisë së Lëvizjes t'fshehtë politike, me Lëvizjen Popullore t'Kosovës, e tjera... Lëvizjes Popullore ma vonë, ishte ruajtur kjo linja e angazhimit atdhetar, edhe jashtë institucional. Prandaj edhe ishte nevoja e domosdoshme e bashkimit t'gjithë këtij potenciali, për t'cilin LDK-ja nuk ishte e gatshme atëherë. Dhe kështu u imponua një rirreshtim, ripozicionim në Kosovë, që çoi pastaj edhe në Konferencën e Rambujesë. Megjithatë gjërat lëvizën pozitivisht, dhe për mendimin tim pa këto zhvillime nuk do t'ishte ky ndryshim edhe i... dhe qëndrim i partnerëve ndërkombëtar, ose qendrave ndërkombëtare të vendosjes.

U siguria një përfaqësim atëhere adekuat, që ishte një përfaqësim nga LDK, një përfaqësim nga LBD, dhe një përfaqësim nga UÇK-ja, me një rol që ne insistonim që t' respektohej, për një pozicionim t'veçantë të UÇK-së, sepse UÇK-ja ishte atëherë forca më e merituar për ndryshimin që u bë, sepse ishin sakrificat ma t'mëdha. UÇK-ja ishte më e rrezikuara që të diskreditohej, dhe të goditej. Prandaj edhe duhej t'favorizuar. Kështu që ishte edhe marrëveshja që në konferencën e Rambujesë, me përfaqësimin e saj, pa UÇK-në t'mos kishte bisedime, dhe UÇK-ja të kishte udhëheqjen në delegacion, dhe UÇK-ja ta dërgonte përfaqësuesin edhe për t'udhëhequr qeverinë që mendonin ta krijonim. Ishte marrëveshja paraprake që kishim bërë, para se t'vendosnim të shkonim në Rambuje.

Me gjithë vërejtjet që kishim, rezervat që kishim, Konferenca e Rambujesë, megjithatë doli pozitive për Kosovën. Bëri kthesën edhe n'saje t'qëndresës që u manifestua në Konferencë, edhe pse kishte edhe anë që mund t'ishin t'abuzueshme edhe nga Serbia, dhe nga miqtë e saj. Ne ishim t'vetëdijshëm për to, por ishim t'bindur se kjo do t'kalohej. Kjo objektivisht edhe u kalua, në pjesën më t'madhe. Por ajo ndarja që shpesh dëgjohet pro e kontra, mendoj që objektivisht të dy palët kanë të drejtë në qasjen e tyre. Ata që e mbrojnë Rambujenë kanë arsye, por injorojnë faktin se po t'mos ishte edhe qëndresa e vazhdueshmeedhe n'Konferencë, po edhe ma vonë, nuk do t'ishin tejkaluar disa sfida, disa gracka që i linte Rambujeja. Po këta që ishin kundër mund t'i injorojnë disa t'arritura t'Rambujesë, po në t'vertetë... nëse nuk e teprojë, ata megjithatë bënë një gjë t'mirë që e trajtonin edhe atë proces si një hallkë t'procesit, si një stacion n'cilin po të binim ne do t'mund të ngecnim, të mbetemi. Prandaj mendoj që duhen t'parë në lëvizje, në proces. Kështu edhe u krijua mundësia për kthesën e madhe që ndodhë n'Kosovë, për ndërhyrjen e NATO-s, dhe krijimit për herë t'parë ndoshta, të një bashkëveprimi midis forcës kryesore t'armatosur të botës dhe forcave atdhetare, liridashëse, çlirimtare, që bashkë pastaj edhe me rreshtimin e Shqipërisë, edhe bëri të parin rreshtim... si t'thushë, historik, pas Luftës t'Dytë Botërore, që kishte sjellë po ashtu një rreshtim të tillë. Dhe Kosova nuk do t'ishte këtu pa këtë bashkëveprim.

Më vjen mirë që unë kam qenë pjesë e këtij procesi, edhe i konferencës t'Rambujesë, edhe i procesit që i parapriu atij. Në angazhimin tim kam pasë pikërisht... edhe unë, me mundësitë e miamodeste, dhe me rolin tim modest aq sa ka qenë, kam synuar pikërisht këtë: ruajtjen e procesit të zgjidhjes të çështjes së pazgjidhur shqiptare në vijimësi, pa djegur etapat, dhe pa fjetur në etapa. Pa rënë në ndikimin e cilësdo force politike, po pa përjashtuar forcat politike, duke synuar bashkimin e tyre, dhe n'këtë mënyrë

optimalizimin e potencialeve tona të munguara praktikisht, edhe vepruese, edhe luftarake, madje shpesh edhe empirike, e tjera.

Pjesa e Gjashtë

Jeta Rexha: Tash nëse kishit mujtë me na tregu për familjen e jujë, domethanë si u takutë ju me bashkëshorten tuj, edhe ku ishit mas luftës, edhe gjatë luftës faktikisht?

Hydajet Hyseni: E tash, kjo... si t'thushë linja familjare është veçanarisht e dhimbshme, në shumë raste. Rasti im mund t'mos jetë më i dhimbshmi sepse unë kam pasë fatin ndoshta... megjithate familjen ta kem të tërën, edhe pas burgut. Kam arritur t'i shoh te dy prindërit. Shumë kush nuk e ka pasë këtë fat. Kam arritur do të thotë të ruaj familjen, jo n'saje timen, po ka arritur familja ime ta ruaj veten. Edhe këtëia detyroj n'radhë t'parë gruas sime, e cila ka sakrifikuar shumë. Ka qenë shumë e vështirë për të t'jetosh në fshat, në kohë linçimi, izolimi, bojkotimi, demonizimi...

Dhe kauzës t'tij, me shpifjet nga më t'poshtrat, t'cilat kanë vazhduar për t'qenë e vërteta në vijimësi. S'janë ndalur kurrë! Sepse s'është ndalur kurrë shëri i UDB-së n'Kosovë. Madje për fat t'keq, as pas burgut. Madje për fat t'keq, as pas luftës. As sot! Vetëm ndryshon format, rrugët, po si sherr vazhdon vazhdimisht. Me shpifje, intriga, nga ma të ultat, nga ma t'pabesueshmet. Dhe funksionon gjithandej. Unë jam shumë i lumtur me këtë fakt! Gruaja ime ka rritur me duar me me thonjë fëmijët e mi, fëmijët tanë. Tre i kishim. Dhe pastaj, meqë i kishim dy djem e një vajzë, kishim dëshirë që t'kishim edhe një pas burgut, me shpresë se ai do t'rritej ndryshe. Ata ishin rritur pa i parë unë. Dhe tani është solvent, Liriku, që është fëmija ynë i katërt. I detyrohem shumë bashkëshortes sime, dhe përpiqem t'ia kompenzoj. Pa modesti fallco mund t'them që edhe ia kam kompenzuar n'masë t'madhe.

Po s'ishte vetëm ajo. Kanë qenë vuajtjet e prindërve t'mi, t'ndjerë tash. Babai im, që ka qenë ai vet pesë, gjashtë vjet nëpër kampe t'përqendrimit, pastaj e ka pasë t'vetmin djalë t'njejtën pozitë. Dhe është mbajtur fort, më fort sesa që kam menduar. Dhe nëna ime që ka pasë vëllezërit, për gjithë jetën e saj me burgje, dhe pastaj djalin e saj t'vetëm. Dhe që megjithate nuk është luhatur asnjëherë. E ia atribuoj si t'thushë këtë qëndresë n'radhë t'parë rrethit familjar, në fshatin tim, Përlepnicën time, që është vërtetë unike për gjithçka. Nuk ka pasë bojkotim atëherë, nuk ka pasë izolim t'familjeve, nuk ka pasë linçim. Përkundrazi, ka pasë solidaritet të paparë. Rinia e fshatit tim kanë shkuar si brigadë punuese, ia kanë punuar babait tim arat. Dhe mua më del tash parasysh kënaqësia që shihja në fytyrën e tij kur m'tregonte, "Biro, mos u mërzi! Gjithçka po shkon mire!" Edhe e përmendte këtë fakt, "T'ri e t'reja kanë ardhë si brigadë pune, dhe arë marë m'ka shku!" I kanë kry puntë n'shejë solidariteti me plakun, po edhe me birin e tij, edhe me kauzën për t'cilën ai po dergjej në burg. Edhe sot kjo më bënë borxhli ndaj tyre. Janë shumë prej tyre n'parti t'ndryshme, janë me pozicione t'ndryshme, po ne jemi shumë afër njëri tjetrit, dhe unë i dua shumë. Edhe ata më respektojnë mendoj, n'masën e duhur. E, individit mund t'qëndrojnë, një familje mund t'qëndrojnë, vetëm nëse e ka ambientin, rrethin, nëse popullit i qëndron.

Kjo e spjegon edhe këtë që ka mbërri Kosova. Kosova ka arritur këtë që e ka arritur sepse u dëshmuar si popull, si vend, se është përgatitur për një ndryshim rrënjësor. Kosova mund t'i arrijë këto që ka përpara vetëm duke dëshmuar se është përgatitur për ndryshimet që e presin. Edhe për integrimin n'Evropë, edhe për integrimin kombëtar, se nuk e përjashtojnë njëra-tjetrën. Është absurde t'mendohet sikur, "Ne duhet t'integrohemi n'Evropë, po s'ban të flasim për integrimin me njëri-tjetrin." E pse? Kujt i prishë punë? Çka prishi punë integrimi i Gjermanisë në integrimin e Evropës? A do t'integrohej Evropa

pa integrimin e Gjermanisë? Jo! Evropa nuk s'do t'integrohej po s'u integrua Gjermania. Po edhe ne në takatin tonë, duke u integruar me njëri tjetrin, me vëllezërit tanë matanë kufirit, që s'është i yni, se kemi bërë ne, se duam ne, nuk i duhet kujt, edhe heqja e tij s'i prishë punë kujt. Vetëm do t'ndihmonim n'normalizimin e raporteve në fqinjësi, dhe me fqinjë. Do t'përfitonin t'gjithë përreth. Unë jam i sigurtë se kështu edhe do t'ndodhë. Po me kushtin që ne të ngritemi në nivelin e përgjegjësisë që kërkon koha.

Unë kam shumë arsye për t'qenë i pakënaqur me shumëçka që kemi bërë, edhe me... shpesh vetveten. Jam i pakënaqur me vetveten shpesh. Por megjithatë jam optimist i papërmisueshëm si thonë, i pandryshueshëm, se ne megjithatë do t'vonohemi, do t'humbim ndoshta rrugën dikund, do t'shkasim dikund, në t'majtë, në t'djathtë, po megjithatë do t'ia dalim. E kam këtë besim jo veç pse e dua, po kam besim shumë te populli ynë, që n'momente krizash... edhe siç thoshte Adem Demaçi, njeriu që me përvojën e tij ka dëshmuar... si t'thushë... dhe ka krijuar modelin e konsistencës e t'qëndresës, "Kur t'binë n'fund t'pusit, atëherë s'ke ku shkon ma poshtë! Vjen edhe ecja përpara, këndellja, kthimi!" Unë jam i bindur që ky popull megjithatë do të gjenerojë forca t'reja, dhe po gjeneron forca t'reja, që do t'ngriten në misionin e e përgjegjësisë historike që kërkohet. Dhe do ta bëjnë këtë vend me dalëzotës.

Jeta Rexha: Tash, me çka mirreni sot? Me çka jeni t'angazhumë?

Hydajet Hyseni: Kam... kam një pjesë t'mirë të krijimtarisë edhe t'burgut që nuk e kam botuar, dhe e përgatis. Pak si gjatë m'ka shkuar kjo punë. Kam një pjesë që e kam shumë përzemër, është krijimtari për fëmi. Dhe janë disa poema, që secila prej tyre bënë një libër n'vete. Dhe mendoj t'i përmbledhë në një botim t'përbashkët. I kam shumë përzemër, sepse i dua shumë fëmitë. Dhe, sa ma shumë kam... si t'thushë, punë me t'riturit, ma shumë më tërheqin... si t'thushë, bota shpirtërore e fëmive, që është e pastër, e dëlirë, e pasherr. Dhe aq ma shumë e ndjej veten borxhli ndaj tyre. Shkruaj nga pak vazhdimisht. Kam edhe plane tjera, dhe kam si t'thushë një opus të mjaftueshëm edhe me shkrime gazetareste, e tjera, të cilat s'i kam përmbledhë, nuk i kam botuar, dhe m'presin. Bëj një punë në "Shoqatën e t'Burgosurve Ish-politikë" Natyrisht, punë benevole, po që më motivon shumë. Se më krijon përshtypjen që sado pak po bëj diçka për bashkëvuajtësit e mi, për shoktë e prangave. Edhe për ata që s'i kam njohur unë, po që kanë pasë pranga n'duar. Dhe më imponon shumë përkushtim.

Jam angazhuar po ashtu në Lëvizjen Vetëvendosje. Konsideroj se është forca politike që... është brumi politik... si t'thushë, që është në vazhden e këtyre përpjekjeve të brezave të tërë, dhe m'duket më mirë se gjithkush tjetër e përfaqëson këtë frymë. Është rinore n'çdo pikëpamje: edhe me moshë, edhe me mendësi, edhe me vizion, edhe me kërkesat që shtron, po edhe që i përgjigjet kërkesave t'kohës. Natyrisht, aty këtu edhe me shfaqjet që ka mosha rinore ndonjëherë, e që dikujt mund t'mos i pëlqejnë. Mund edhe të jenë të diskutueshme ndonjëherë, po që mua më duket megjithatë duhet të bëjë edhe unë argatin tim. M'duket ni mënyrë vetja si me fëmitë e mi. Ndonjëherë me ta kam edhe ndonjë dallim t'vogël, por ajo që m'bashkon është tepër e fortë, e veçantë. Ndonjë punë mund ta bëj edhe unë, siç e bëjnë ata, po kur e bëjnë ata sesi m'duket diqysh më e sigurtë. Unë jam vozitës, shofer, po kur shkojmë familjarisht në rrugë me makinë, ma përpara preferoj gjithmonë që timonin ta kenë djemtë e mi, ose rejat e mia, ose vajza ime. Se janë... u besoj ma shumë syve t'tyre, u besoj ma shumë instinkteve t'tyre, u besoj ma shumë duarve t'tyre, e tjera. Dhe ndjehem mirë! Aty këtu, mund edhe t'u them ndonjë vërejtje, ndonjë sygjerim, e tjera. Nuk ma kuptojnë keq!

Jeta Rexha: Falemnderit shumë! Për fund, n'qoftë se keni me shtu diçka?

Hydajet Hyseni: Jo nuk... Tash edhe jam pak i shkapërderdhur. Ta tham t'drejtën, e kam bisedën sikur kur kam biseduar me dy vajza jo për regjistrim, jo për media, po thjesht bisedë kështu. Nuk del gjithmonë mirë kjo, po ja, kështu u ndjeva!

Jeta Rexha: Na vjen mirë! Falemnderit shumë!